




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Procesverbal

Nga Seanca e shtatëmbëdhjetë (XVII) e Kuvendit të Komunës, mbajtur më 27. 4.2011 me këtë:

REND PUNE

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të kuvendit dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e kaluar,
2. Informatë (konkluzionet) nga takimi me qytetarë i Nënkrjetarit të Komunës për komunitete,
3. Mandatimi i Komisionit për hartimin e akteve komunale,

4. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

1. Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Gjiçanit,
2. Raporti Financiar Janar-Mars 2011,
3. Informatë për manifestimin "Flaka e Janarit" 2011,
4. Propozim-vendimi për shpalljen e Interesit publik për shpronësim të paluajtshmërive për rregullimin e infrastrukturës rrugore në Komunën e Gjiçanit,
5. Propozim vendimi për përkrahjen e krijimit të Zonës Ekonomike me Komunën e Novo Berdes,
6. Propozim-Statuti i Teatrit Profesionist të Qytetit të Gjiçanit,
7. Propozim vendimi për themelimin e Trupës profesioniste Muzikore të Qytetit,
8. Propozim vendimi për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës për aftësimin profesional dhe Qendrën e punësimit,
9. Propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01.Nr.5817 për shpalljen Zonë me interes të përgjithshëm publik të ngastrave nr.1961-1 dhe Nr.1961-2.
10. Propozim vendimi për subvencionimin e qirasë për familjet me gjendje të rëndë ekonomike,
11. Propozim vendimi për të drejtat, obligimet dhe përgjegjësit e Komisionit për vlerësimin e aseteve të K.R.M. "Higjiçena" në Gjiçan, Kamenicë dhe Viti.
12. Strategjia Komunale për kthim të qëndrueshëm dhe ri integrim 2011-2014
13. Kriteret për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve për student të dalluar të Gjiçanit për vitin akademik 2010/2011,

14. Informatë 3 mujore e punës së Komiteteve të KK-s,

5. Të ndryshme,

Seanca filloi punimet në ora 10.20 min

Kryesuesi i Kuvendit
Izmi Zeka

Të pranishëm në punimet e Seancës së shtatëmbëdhjetë ishin:

Anëtarët e Kuvendit,

Kryetari i Komunës, z. Qemajl Mustafa

Zv/kryetari i Komunës, z. Omer Daku

Drejtorët e drejtorive

Përfaqësuesit e MPL-së

Përfaqësuesit e OSB-së

Njësia për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut

Një grup i qytetarëve nga Lagjja “Dheu i Bardhë”

Mediet

Seancën e shtatëmbëdhjetë e hapi kryesuesi i Kuvendit, z. Izmi Zeka i cili në fillim i përshëndeti anëtarët e Kuvendit, përfaqësuesit e Shoqërisë Civile, përfaqësuesit e OSB-së, por në veçanti përfaqësuesit e Pushtetit Lokal, anëtarët e Kuvendit, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë në këtë seancë.

Me kërkesë të kryesuesit të Kuvendit sekretaria konstatoi se në këtë seancë janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Kuvendit.

Në vazhdim të seancës, kryesuesi theksoi se kjo është seancë e hapur dhe ka të drejtë secili për ta marrë fjalën, prandaj në këtë seancë në fillim fjalën do ta ketë një qytetar nga lagjja “Dheu i Bardhë” i cili do t’i shpresë shqetësimet e qytetarëve të asaj lagjeje.

Tahir Borovci- z. Tahiri së pari e falënderoi kryesuesin i cili ia dha mundësinë për t’i shprehë brengat e tij, por jo të tij personale, por të gjithë banorëve të lagjes “Dheu i Bardhë”. Shqetësimet kryesore të banorëve të kësaj lagjeje ishin sidomos në infrastrukturë, sidomos ajo e rrugëve, sepse në tërë këtë lagjeje fare nuk janë rrugët e asfaltuara, nuk ka trotuare të mjaftueshme për qytetarë dhe nxënës të cilët kanë mjaft vështirësi gjatë rrugës për të vijuar në shkollë.

Si problem tjetër z. Tahiri paraqiti edhe mosfunksionimin kanalizimit në këtë lagjeje deri tek Lumi Stanishorka dhe gjatë të reshurave është e pamundur për të kaluar njerëzit.

Të gjithë këta qytetarë të kësaj lagjeje kanë dhënë kontribut vullnetar për infrastrukturë, duke investuar në rrjetin e rrymës etj, por përsëri KEK-u na ka rendit në kategorinë “C” për shkak të lagjes së romëve edhe pse ne i kemi obligimet e shlyera 100%.

Ne kërkojmë që Kuvendi Komunal ta shqyrtojë këtë rast, pse ne gjendemi në kategorinë “C:” pa asnjë arsye, por edhe të marrin masa të tjera për ta përmirësuar tërë infrastrukturën rrugore.

Një kërkesë tjetër është që Kuvendi Komunal të shqyrtojë mundësinë dhe të merr hapa që punëtorëve të kombinatit të Tekstilit t’i kompensohet 20%.

Izmi zeka- lidhur me fjalën e z. Tahirit, kryesuesi i Kuvendit theksoi se sa i përket çështjes së rrugëve, ne si Komunë i kemi të projektuara të gjitha dhe nuk do të mbetët asnjë rrugë për pa u

asfaltuar. Mirëpo sa i përket çështjes së 20% dhe KEK-ut , ne mund të bëjmë përpjekje për t' i lëvizur këto gjëra, por këto nuk janë kompetencë e KK-së.

E falënderojmë z. Tahirin për informatën të cilën na e dha, por edhe ne jemi të njohur për problemet të cilat ekzistojnë në atë lagje.

Arben Mehmeti- lidhur me fjalën e këtij qytetari i cili e foli para anëtarëve të Kuvendit, është e drejtë e tij që t' i paraqes problemet , por jo në emër të lagjes, sepse nga kjo lagje i kemi disa anëtarë të Kuvendit e të cilët janë më të autorizuar të flasin këta njerëz.

Tjetër është se desha ta njoftoj Kuvendin se gjatë një debati të cilin e kemi pasur në Hotelin “Kristal” para disa dite në të cilin debat ka qenë si temë investimet e PPP-së në Komunën e Gjilanit. Në këtë takim unë kam marrë pjesë si përfaqësues i grupimit politik të LDK-së dhe në këtë debat unë e kam pasur një vërejtje se ata zyrtarë të cilët kanë ardhë nga AKM- në Komunën e Gjilanit, kam shfaqur dyshimin se mund të kenë sukses në ato projekte, sepse AKM në tërë Kosovën është një mision i dështuar. Adresimi i im nuk ka pasur të bëjë asgjë me çështje personale, mirëpo unë më vonë kam marrë një kërcënim nga një zyrtar i Komunës së Gjilanit i cili merret me investime PP dhe i cili ende nuk posedon kontratë pune valide, por e merr atë të drejtë për të kërcënuar zyrtarë partiakë dhe zyrtarë institucional, por në këtë rast komplet një parti politike.

Unë kërkoj që përmes këtij Kuvendi, kryesuesit t' i tërheq vërejtjen këtij personi që të ndalohet forma e kërcënimit ndaj këshilltarëve komunal. Kjo praktikë nuk ka qenë praktikë në Komunën e Gjilanit dhe për mua është kërcënim i parë që vjen nga një zyrtarë i Administratë Komunale, ende i pa legalizuar juridikisht. Për këtë unë kërkoj që t' i merrni të gjitha masat ligjore dhe ai zyrtarë të sanksionohet në mënyrë legale. Unë njëherë këtij njeriu nuk kam desh t' ia përmend emrin, por po përmendi dhe po e them se ky është Afrim Hoti, i cili është i punësuar vetë, por edhe bashkëshorten e ka drejtoreshë në “Hidroteknikë” dhe kjo është një konflikt i radhës së interesit.

Kjo është e patolerueshme dhe në seancën e radhës së Kuvendit, kërkoj nga kryesuesi që të na njoftoj përkitazi me masat të cilat janë ndërmarrë nga Komuna e Gjilanit për këtë veprim! Ky veprim nuk ka qenë praktikë në Gjilan dhe është mirë dhe duhet patjetër të ndalohet ky veprim, sepse këtu ka institucione, ka ligj dhe ka rregull.

Izmi Zeka- nuk ka të drejtë askush askujt t' ia thotë asnjë fjalë për çështje të përgjithshme, ju jeni përfaqësues i një subjekti politik dhe aty nuk e përfaqësoni veten. Nuk është e drejtë e askujt të thërras në telefon, por as në forma të tjera të bëjë gjëra të tilla.

Unë do të kërkoj me shkrim dhe do të interesohem kush është ai njeri? Kush do që të jetë ajo, është formë e padrejtë për të bërë kërcënime ndaj dikujt. Unë në seancën e ardhme kërkoj që ky person këtu të sqarojë mënyrën e komunikimit si e ka bërë ai person.

Sokol Haziri- unë po e them vetëm një fjali dhe po e mbështesë këshilltarin e LDK-së z. Arben Mehmeti dhe definitivisht edhe grupi AAK-së kërkon që të merren masa dhe për mua ai person është i padenjë për ta ushtruar atë detyrë. Është përgjegjësi e juaja për të marrë masa!

Lidhur me rendin e punës po e them se edhe pse parimisht jemi pajtuar në takimin e grupeve të shfave që të jetë ky rend i punës, ne në emër të grupit të AAK-së kemi propozim që pika e 7 e rendit të ditës të shtyhet për një kohë të caktuar, në mënyrë që të jemi më të përgatitur derisa të bëhen konsultimet nevojshme me të gjitha grupet e interesit. Kjo fazë të jetë fazë e konsultimeve dhe takimeve me të gjithë përfaqësuesit e kësaj lëmie, në mënyrë që të njoftohemi dhe të konsultohemi se si do të ishte më mirë të veprohet. Unë mendoj se trupat amatore dhe profesioniste dallojnë dhe këto dy nocione dallohen shumë qartë. E çmojmë atë që Gjilani të ketë trup profesioniste, por kërkojmë që të kemi më tepër kohë për të bërë analiza dhe konsulta lidhur me këtë pikë të rendit të punës.

Elisah Ymeri- ne emër të grupit të PDK-së kërkojmë që pika e 11 të hiqet nga rendi i ditës, sepse kërkojmë nga komisioni që ta na e bëjnë një raport lidhur me vlerësimin e aseteve, kurse më vonë të vazhdojmë me procedura të tjera.

Arben Malqi- së pari i uroj punë të mbarë drejtoreshë së urbanizmit punë të mbarë dhe suksese dhe më vjen mirë që edhe gjinia femërore po respektohet dhe po zgjidhet në vende udhëheqëse.

Mua më vjen mirë që edhe AAK është kthjell të cilët ma morën pikën time, por edhe unë e kam ngrit këtë çështje, por nuk është pika 7 e rendit të ditës, por është pika 4 dhe unë jam që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës për të cilën kam mjaft për të thënë, por po e them se duhet të hiqet.

Ibrahim Neziri- edhe ne, në emër të grupit G-3 kërkojmë që pika 7 të hiqet nga rendi i ditës.

Shkëlqim Latifi- unë do ta paraqes një shqetësim të banorëve të fshatit Pogragjë, për të cilin rast me mua do të pajtohen edhe këshilltarët e tjerë nga ky fshat. Çështja ka të bëjë me një seperacion në hyrje të këtij fshati. Unë këtë problematikë e kam ngrit edhe vitin e kaluar, e kam paraqit në Inspeksion të cilët kanë ndërmarrë disa masa i kanë vendos disa shirita, mirëpo ai pronori nuk i ka respektuar ato masa dhe ka vazhduar me punë gjatë tërë vitit. Unë përsëri kam qenë në Inspeksion, por ai e ka marrë edhe një vendim nga Ministria e Ambientit, kurse drejtori ka bërë edhe padi në gjykatë, por nuk e di se si ka arrit që ta marrë pëlqimin nga ministria. Ne jemi këtu për ta mbrojtur interesin publik, prandaj unë kërkoj nga drejtori i Inspeksionit dhe ai për Shërbime Publike që ta konstatojnë gjendjen dhe urgjentisht të marrin diçka, sepse rruga Pogragjë- Sllubicë është e degraduar në tërësi. Përveç shkatërrimit të rrugës ndotjes së ambientit aty është e rrezikuar dhe jeta e qytetarëve, sepse aty qarkullojnë kamionët të cilët i vozisin djemtë e rinj të cilët nuk e posedojnë kategorinë përkatëse për vozitje. Aty edhe bëhet edhe një vozitje shumë e shpejtë dhe me një mbingarkesë për ato automjete! Ky shqetësim është i tërë banorëve, prandaj kërkoj nga këto drejtori përkatëse që t' i parandalojnë këto gjëra.

Tahir Arifi- unë po inkuadrohem në atë që ishte kërkesë e grupit të AAK-së lidhur me propozimin për themelimin e Trupës Profesionale Muzikore, për të cilën nuk ka problem nëse është disponim i përgjithshëm, mund të shtyhet, por unë nuk e pashtë arsyetimin pse duhet të shtyhet? Unë do të kisha dëshirë për ta pasur një arsye!

Ky propozim është dokument inicial në këtë fazë dhe unë i kuptoj shqetësimet e grupeve muzikore të tjera të cilat kanë funksionuar si amatore në Komunën e Gjilanit, por kjo është dokument inicial fillimisht dhe bashkërisht i kemi bërë të gjitha përpjekjet për hapat e mëtejshëm për themelimin e Trupës Profesionale Muzikore, të mos i vërtetojnë shqetësimet e grupeve të tjera amatore. Ky Kuvend do të duhej që në këtë dokument inicial të shoh mundësinë e vet që ta bëjë Trupën Profesionale Muzikore, kurse për kriteret dhe mënyrën e funksionimit e asaj trupe ta kontrollojë ky Kuvend ashtu siç duhet, mandej kur të kenë pakënaqësi eventuale të arsyeshme ato të eliminohen. Mirëpo nëse është kërkesë e këshilltarëve që kjo pikë të shtyhet nuk kemi asgjë kundër.

Sarandë Bllaca- në emër të grupit të këshilltarëve të LDD-së kërkojmë që pika e 7 e rendit të ditës të shtyhet për një seancë tjetër, të përfillen të gjitha procedurat dhe të jenë një arsyetim më i denjë, të mbahet një debat më i gjerë në të cilin do të merrnin pjesë përfaqësuesit e grupimeve parlamentare dhe përfaqësues të ansambleve ekzistuese, pastaj të vijë në Kuvend.

Riad Rashiti- pasi që jam kryesues i tij, unë e shpreh qëndrimin tim personal me të vetmen arsye; në seancën e kaluar e cila është mbajtur më 29 mars 2011, Kuvendi ka marrë një vendim. Mirëpo vendimi që është propozuar sot nuk dallon asgjë nga vendimi që është marrë në seancën e kaluar,

përveç pikës 6 dhe 7 të cilat nuk debatohen në rend të ditës, prandaj nuk e mbështes atë që kjo pikë të shtyhet për seancën tjetër.

Abdyl Aliu- unë e kam një kërkesë që në seancën e radhës të futet një pikë e rendit të ditës e cila ka të bëjë me zbatueshmërinë e vendimit të KK-së në Gjilan nr. 01/4732/ 020 të datës 8.7.2002.

Mirëpo i kam edhe dy çështje të tjera për nën të ndryshme: njëra ka të bëjë me Stadiumin e qytetit në Gjilan, kurse tjetra me lejet ndërtimore.

Tahir Arifi- procedurat për inicimin e Trupës Profesioniste Muzikore, kanë qenë që të gjitha në rregull dhe janë ndjekur të gjitha procedurat. Këtu nuk ka asnjë kontestim, janë mbajtur debatet, por duhet thënë se është një përpjekje 20 vjeçare për t' u formuar Trupa Profesioniste Muzikore.

Por është edhe një obligim ligjor që Komuna të formojë Trupën Profesioniste Muzikore.

Unë u pajtova me atë nëse është disponim i të gjithë për ta shtyrë dhe biseduar dhe nuk ka asnjë problem, por kjo është interes i Komunës së Gjilanit dhe i të gjithëve që Gjilani ta ketë Trupën Profesioniste Muzikore si qytet.

Mimozë Shkodra- Bislimi- unë do të isha në pajtim me këtë pikë të rendit të ditës, nëse do të kishte ndodhur kështu edhe me sportin në Gjilan. Kam bindjen se ka suksese dhe nuk mund të them se nuk ka në njëfarë mënyre më shumë se Trupa Profesioniste Muzikore. Duhet thënë se klubet sportive tona shkojnë në Itali, Holandë, Danimarkë etj. të cilat e përfaqësojnë Gjilanin në Evropë.

Nuk jam kundër nëse ndodh e njëjta edhe për sportin.

Izmi Zeka- së pari për Shkëlqimin po e them atë që e tha nuk do të duhej të thuhet në Kuvend kjo çështje, sepse janë organet ekzekutive të cilat duhet të merren me këto gjëra.

Sa i përket Trupës Profesionale Muzikore është disponim i të gjithëve për t' u shtyrë dhe të mbahen debate konsultative me grupet profesionale, por ne në seancën e ardhme do ta propozojmë si të plotësuar. Sa i përket propozimit të Elisahut, ajo është e drejtë, ne do ta kemi një raport, por edhe disa pika bien ndesh me disa pika të Komisionit, sepse komisioni është bërë vetëm për vlerësim të aseteve.

Riad Rashti- në seancën e 29 marsit 2011 është marrë vendim, pika 5 përmes këtij vendimi : “autorizohet Komisioni i autorizuar nga KK-Gjilan për vlerësimin të asteve KRM “Higjiena” që në bashkëpunim me Zyrën e investimeve për PP dhe Zyrën e prokurimit pas përpilimit të kritereve të shpallet ftesa për ofertim të hapur.....”

Ne si komision pas kësaj pikë nuk e kemi të drejtën as të ofertave, as të hapjes së tyre, sepse Zyra e Prokurimit e bën shpalljen e tenderit, kurse ne si komision nuk e kemi këtë të drejtë.

Sokol Haziri- unë jam pjesë e këtij komisioni dhe unë pajtohem që kjo çështje të shtyhet në takimin e radhës të shihet nëse është bërë ndonjë lëshim. Është vendimi të cilin e lexoi Riadi dhe sa i përket raportit ne jemi pajtuar që me përfundimin e punës që pritet të përfundojë në fundin e javës t' i drejtohem Kuvendit me një informatë apo raport. Absolutisht nuk ka pengesë që vendimin që e lexoi Riadi mos të jetë valid dhe i vlefshëm. Nëse ka ndonjë pengesë në Komision unë mund edhe të mos jem dhe nuk do të ketë problem as për mua dhe grupimin tim politik. Këtu çdo gjë është e qartë me përjashtim të moskuptimeve dhe çështjeve teknike asgjë nuk ka të paqartë, prandaj të mbetet vendimi fillestar që ka qenë

Qemajl Mustafa- unë po e them se këto pika duhet të harmonizohen, sepse unë e kam propozuar si ide preliminare njëfarë drafti, por që duhet të harmonizohet me ligjin. Ky komision është themeluar për t' i paraprirë procesit dhe për të qenë në proces dhe për ta monitoruar atë proces.

T' i paraprihet në kuptimin e transparencës së plotë, sa i përket kësaj kompanie e cila është e rëndësishme për dhënien e shërbimeve në qytet, për të ndërtuar kushte për atë vlerësim dhe për të kontribuar gjatë vlerësimit të atyre asteve për të qenë sa më real i mundshëm. Kjo ka qenë ideja, por për të mos themeluar komision pas komisioni unë kam qenë për atë që këtij komisioni t' i zgjatet mandati edhe në monitorim të gjithë procesit i cili fakt bien në pajtim me ligjin për PP.

Te Trupa Muzikore, pajtohem me Tahirin që qysh plotë akte i kemi ndal dhe i kemi kthyer në rishqyrtim që të ndodh edhe kjo! Mirëpo e di që gjatë tri viteve kemi debatuar disa herë në të cilat debate ka pasur mospajtime, por gjithherë do të ketë grupime të ndryshme të cilat nuk do të pajtohen për shumë arsyeje.

Ejup Haziri- lidhur me pikën e rendit të ditës pika 11 po theksoj se grupi i PDK-së nuk ka pasur tendencë as ndaj komisionit as për ta zvarrit procesin. Qëllimi i jonë ka qenë pikërisht ajo e cila është zbërthyer këtu. Ne kërkojmë një propozim –vendim i cili do të jetë në harmoni të plotë me fjalët që u thanë sot edhe nga kryetari komisionit dhe kryetari i Komunës.

Në seancën tjetër të na sillet një raport për punën të cilën e kanë bërë dhe një pikë të rendit të ditës për këtë që po thuhet sot, me një fjalë me një ridefinim, sepse sekretaria nuk i ka radhit mirë.!

Izmi Zeka- unë mendoj që duhet të harmonizohet me ligjin dhe ne në afatin sa më të shpejtë ne mund ta thërrasim edhe një seancë dhe të kalojë kjo çështje. Mirëpo komisioni i cili e ka bërë vlerësimin e aseteve nuk mund të jetë pa një vendim të veçantë të Kuvendit.

Riad Rashiti- unë pajtohem me këtë, por kërkoj që në seancën e ardhme të anulohet pika 5 e vendimit të seancës së kaluar.

Izmi Zeka- a jeni që kjo të harmonizohet mirë, pastaj të del në Kuvend, kurse për Trupën Profesionale Muzikore për shkak të hezitimit të grupeve dhe shefave të grupeve parlamentare, kërkoj nga Drejtoria që të thirren të gjitha grupet artistike të debatohet mirë dhe të shteren të gjitha mundësitë e dabitit dhe në seancën e ardhme të propozohet në këtë Kuvend.

Në fund të debatit, kryesuesi propozoi që këto dy pika të shtyhen, kurse të vazhdohet me pika të tjera të rendit të punës?

Aprovohet rendi i ditës me vota unanime, me këto ndryshime

Procesverbali

Nuk pati vërejtje në procesverbal dhe u aprovua pa vërejtje

2. Informatë (konkluzionet) nga takimi me qytetarë i Nënkryetarit të Komunës për komunitete,

Izmi Zeka- ne e kemi fut në rendin e punës këtë pikë, por përfaqësuesi për komunitete nuk është këtu, prandaj nuk kemi pse ta debatojmë !

3. Mandatimi i Komisionit për hartimin e akteve komunale,

Izmi Zeka- ne e kemi Komisioni për ndryshime statutare i cili është duke punuar, por neve po na paraqitet nevoja për përpilim të shumë rregulloreve dhe akteve tjera, kemi vlerësuar që ky Komision për ndryshime statutare, në çastin që e përfundon punën të formohet një komision i veçantë i cili do

të ketë autorizim deri në fund të mandatit për këto çështje. Ky komision të merret me hartimin e rregulloreve dhe akteve të tjera gjatë tëri këtij mandati që mos të merremi në tërë kohën me formim të komisioneve.

Sadri Arfi- qëllimi i këtij komisioni dhe mandatimi i tij deri në fund të këtij mandati është që të mos formohet në çdo seancë nga një komision. Unë po i njoftoj se prej fillimit të këtij viti kemi një komision për formimin e këshillave të fshatrave, një për dhënie në menaxhim të vend gjuetive, një për kompensim të zyrtarëve të lartë të Komunës dhe disa të tjerë.

Qëllimi i formimit të këtij Komisioni është që të formohet një Komision profesional në mënyrë që mos të ngecin disa punë ashtu siç i kemi disa raste.

Mirëpo ky komision stautar në një pikë të vendimit do të thuhet se e kanë të drejtën e ndërrimit të ndonjë anëtari në rast se paraqitet nevoja.

Izmi Zeka- komisioni që është formuar për vendosjen e Busteve, Shtatoreve dhe Lapidarëve ka mbetur në vend numërim dhe ka komisione të cilat kanë mbetur në gjysmë të rrugës.

Sokol Haziri- grupimi i ynë politik është plotësisht në dakord që të ekzistojë një komision i tillë i përhershëm, sepse shumë akte normative nxirren nga ky Kuvend, prandaj Kuvendi duhet ta ketë një komision të tillë. Ne absolutisht e mbështesim një propozim të tillë me një kërkesë që emrat t' i rishqyrtojnë partitë. Mirëpo kam edhe një kërkesë për shefin e Shërbimit të Kuvendit, që komisionet të cilat i përmendi të na sillet një listë edhe neve si grupim politik.

Aprovohet pika 3 e rendit të punës me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit.

Qemajl Mustafa- unë jam për dhe është mirë nevojat po na dërgojnë tek këto ide. Ne gjatë punës në praktikë po e krijojmë rendin dhe rregullën. Do të duhej më kreativisht të uleni dhe ta debatoni këtë çështje si grupimet politike, por sidomos KPF-ja se si t' i lidhet gryka kësaj pune. Kjo është një hap kualitativ përpara, sepse kemi ardh në një konstatim se prej shumë komisioneve duhet të bëhet një komision, sepse është e vërtetë se po bëhet një numër i madh i komisioneve. Mirëpo problemi është se edhe ky komision nuk e zgjidh punën, sepse ky komision merret me lloj-lloj problematike dhe ky komision prapë do të vijë në nevojë për të themeluar nën komisione. Unë përshëndes formimin e një komisioni të përhershëm i cili në ndërkohë edhe mund ta kryej misionin e vetë së bashku me këto nën komisione, por edhe mund të na ndihmojë për ta projektuar ndonjë akt i cili do t' i shërbejë Kuvendit.

Tahir Arfi- me sa e kuptova unë ne e votuam një komision pa emra, por i cili do t' i ndërrojë emrat varësisht prej problematikës që do të paraqitet para atij komisioni. Unë kështu e kam kuptuar!

Izmi Zeka- ka të drejtë kryetari, por përgjegjësinë duhet ta ketë ky komision, sepse me të vërtetë nuk po funksionojnë, këtë po e them nga praktika.

Gjashtë komisione janë këtu, por puna nuk po kryhet. Mirëpo edhe një gjë po them në këso raste dërgoni njerëz profesional.

Qeamjl Musta- ndoshta do të duhej kryesuesi të ulet me përfaqësimet politike dhe të dizajnohet një çelës, jo të jenë të gjithë juristë, por të shihet se çfarë kuadri duhet të ketë sa juristë sa inxhi. ekonomistë etj. Këta të jenë njerëz kredibil të cilët i njohin lëmitë e veta dhe kanë diapazon më të gjerë të njohurive.

Sadudin Berisha- unë desha ta kuptoj qëllimin e mirë, sepse Komisioni për ndryshime statutare dhe zgjerimi i veprimtarisë nënligjore dhe akteve normative që janë bazike për funksionimin e KK-së është e domosdoshme të jetë një mekanizëm siç është ky komision. Mirëpo ngulfatja e këtij komisioni edhe me çështje periferike siç është ajo me marrjen e vendimit për vendosjen e Busteve, del jashtë kompetencave dhe jashtë fushës së sajë. Unë mendoj se duhet ta kemi një Komision për hartimin, plotësimin dhe ndryshimin e Statutit dhe akteve tjera nënligjore që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë në kuadër të statusit që përcaktohen. Ky komision dallon prej komiteteve, prandaj unë kujtoj se ky komision duhet saktësisht ta dijë veprimtarinë e vet, me mundësi të themelimit të komisioneve për fusha të caktuara. Ne mbështesim si grup politik që të jetë një trup profesionale që ka të bëjë jo vetëm me aktet normative nën ligjore, por edhe me statut.

Izmi Zeka- të jetë pra komisioni për ndryshime statutare dhe akteve tjera normative

4. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

1. Informatë për gjendjen e sigurisë në Komunën e Gjilanit

Omer Daku- unë do të jem shkurtës, sepse një informatë e tillë do të jetë nëpër të gjitha seancat në vijim, sepse kjo ka ardhur si rezultat i një Udhëzimi administrativ i cili është nr. 8 /2009 nga Njësia e Punëve të Brendshme po ashtu 2/2009 të MPL-së të vitit 2009 dhe 2010. Ne e dimë se deri në muajin maj Komuna ka qenë në procesin zgjedhor, por ne si KKSBB jemi munduar që të veprojmë dhe të përpilojmë një rregullore të punës, mirëpo ne e kemi parë të rrugës që ajo rregullore duke u bazuar në Udhëzimin administrativ të vijë në Kuvend të cilën e keni aprovuar me disa plotësime. Tani e kemi të plotësuar në tërësi rregulloren e KKSBB-së dhe duke i mbajtur takimet tona të rregullta. Mirëpo në një nga takimet nga ky Kuvend ka qenë një kërkesë që të merret një raport nga Policia e Kosovës. Ne këtë e kemi fut në rend të ditës dhe e kemi debatuar të cilën e keni në materialet e juaja. Sot kam biseduar me komandantin, por ai ka pasur një takim tjetër, sepse ka qenë desh të jetë pjesë e asaj tryeze e cila është organizuar edhe me OSB-në. Mirëpo ai deklaroi se do të jetë i pranishëm në Kuvend dhe përpos që i keni materialet, këtu do të jetë prezent edhe komandantin dhe pos asaj pike mund të shtrohen edhe çështje të tjera. KKSBB-ja takimet e saja po i mban të rregullta, por e kemi edhe një material tjetër vijues i cili do të vijë në seancën e radhës dhe kështu do të vazhdojmë. Po ashtu edhe ekipet vepruese për siguri në komunitet kanë funksionuar i kemi riaktivizuar dhe ato janë në funksion. Mendoj se për fillim është një nismë e mirë dhe kështu do të vazhdojmë.

Sami Azemi- fshati Pogragjë nuk është i sigurt, sepse ky fshat kufizohet me Kosovën Lindore dhe kjo rrugë lidhet me Komunën e Bujanocit. Në këtë rrugë kontrabandohen mallra të ndryshëm dhe kështu dëmtohet me të madhe buxheti i Kosovës, por edhe i Komunës së Gjilanit. Kjo pikë nuk është në veri, por në Lindje të Kosovës dhe ka mundësi të shndërrohet në fenomen. Kjo dukuri është shfaq qysh nga paraluftra dhe po vazhdon edhe tash. Por shqetësim tjetër i këtyre fshatrave është edhe siguria e tyre, sepse Policia e Kosovës nuk ka pikë statike dhe njerëzit që merren me këtë dukuri ata i përcjellin në çdo çast dhe në momentin që policia largohet, atëherë banorët e fshatit Pogragjë bien në dert. Aty hyjnë makinat me ngarkesa të mëdha dhe të cilat i ngasin me shpejtësi të madhe. Kjo dukuri mund të parandalohet nëse Policia e Kosovës e bën një pikë statike, në fshatin Pogragjë ose të bëhet një punkt i Policisë në këtë fshat për ta eliminuar këtë dukuri.

Qemajl Mustafa- këtë çështje e kemi ngrit disa herë brenda tri viteve, sepse ka qenë shqetësim i përhershëm i banorëve të fshatit Stublinë. Kjo çështje kështu është ngrit si po e ngrit Samiu sot.

Këtë e dinë edhe KFOR-i i cili e ka përgjegjësinë në zonën kufitare, por e dinë edhe Policia e Kufitare e cila si autoritet e ka përgjegjësinë për funksionim të kufirit.

E vërteta është se kjo nuk është zgjidh në mënyrë sistimore si ne duam, sepse do të duhet të ketë punkte të përhershme për t' i mbyll vrimat atje ku rrjedh.

Ne këtë e kemi ngrit disa herë, sepse njëherë ka qenë një shqetësim për ata që merreshin me therje të kafshëve dhe shitje të mishit. Mirëpo kjo doli se Policia kufitare nuk e kishte ngrit këtë problematikë, sepse disa prej tyre kanë qenë të involvuar në këtë proces.

Ne do ta ngrisim edhe njëherë këtë dukuri në organet kompetente të sigurisë.

2. Raporti Financiar Janar-Mars 2011

Nuhi Nuhiu- sipas ligjit për financa ne jemi të obliguar që të raportojmë për gjendjen financiare në çdo tre muaj, por ne në tre mujorin e kaluar kemi pasur një buxhet shumë të kufizuar për arsye se buxheti është aprovuar në fund të marsit. Për këtë arsye ne kemi qenë të shtrënguar që të kursejmë dhe më pak se sa nevojat minimale që i kemi pasur.

Gjatë këtij tre mujori kemi pasur shpenzime mbi 2 milion e 900 mijë euro në total duke hyrë pagat mallrat, shërbimet, komunalit, subvencionet dhe të tjerat.

Sa i përket investimeve kapitale nuk është shpenzuar asnjë cent, për arsye të mos aprovimit të buxhet për të cilin shkak edhe nuk na janë alokuar mjetet nga grandit dhe të hyrat vetanake të cilat i kemi bartur nga viti 2010.

Nga të hyrat vetanake janë alokuar dhe shpenzuar 161.785.50 euro, kurse totali i të hyrave vetanake është diku mbi 600 mijë euro, prandaj edhe nga të hyrat vetanake nuk na është lejuar që t' i shpenzojmë për të cilën arsye kemi mbetur edhe pa i shlyer disa obligime.

Shpenzimet nuk kemi pasur mundësi t' i paraqesim në pasqyrë, sepse shpenzimi është bërë në bazë të planifikimit të vitit 2010. Kjo është arsyeja pse nuk e kemi planifikimin, por pas aprovimit të buxhetit nga qeveria, hyjmë në tre mujorin e dytë dhe kështu do ta keni edhe planifikimin e asaj kohe. Në fund po theksoj se kemi pasur vështirësi për shkak të buxhetit të limituar, por të hyrat vetanake kemi arrit që t' i realizojmë mbi 92% dhe krahasuar me vitin paraprak kemi një ngritje të hyrave vetanake 27%. Gjendja është e mirë tek të hyrat vetanake, kurse pjesa më e madhe e këtyre të hyrave janë shpenzuar për paga dhe mëditje të cilat janë nga grandit, mirëpo shpenzime kapitale nuk kemi pasur asnjë cent.

Abdyl Aliu- në të gjitha raportet e deritashme tremujore, gjashtëmujore, nëntëmuajore dhe në atë për vitin 2010, kemi pasur rast që të hasim në shumë gabime teknike, gjuhësore, profesionale, shpenzime enorme të mëdha dhe të panevojshme. Këto shpenzime të panevojshme janë bërë sipas kodeve të ndryshme në ushqim, pije et.

Mirëpo kësaj radhe për këta tre muaj më duhet të pranoj që hartuesit e raportit janë përkujdesur që të ketë më pak vërejtje dhe gabime. Mirëpo kjo nuk është arrit duke përmirësuar performancën dhe efektivitetin në punë, por këtë e kanë bërë duke e përmbledhur tërë këtë punë vetëm në 4 faqe(tabela) raport.

Në këtë raport janë vetëm 4 tabela, por pse është kështu e din hartuesit e raportit. Këto 4 faqe, nuk janë një bazë e mjaftueshme për t' iu raportuar taksapaguesve të Komunës se si janë harxhuar tre milion euro! Është e ditur se çka duhet të përmbajë raporti financiar, por e dinë edhe hartuesit se çka duhet të përmbajë një raport i tillë për të qenë temë për debat?

Raporti për vitin 2010 i përmban 48 faqe, raporti nëntë mujor i përmban 36 faqe, kurse ky i përmban vetëm 4 faqe. Kjo nuk donë koment dhe nuk ka ndonjë bazë për ta debatuar.

Unë e kam vetëm një vërejtje e cila është mjaft e madhe dhe e ka emrin jo transparencë!

Zijadin Maliqi- ky raport është tre mujor, nuk kemi pasur buxhet, sepse ka qenë i pa alokuar, por unë dhe grupi im e përkrahim këtë raport edhe pse është dhënë vetëm në mënyrë sintetike dhe jo në

mënyrë analitike për shpenzime. Mirëpo duke marrë parasysh se kësaj radhe shpenzimet për mallra dhe shërbime kanë qenë të vogla, sepse pjesa më madhe janë shpenzua për paga, ne në gjashtëmujor besojmë se raporti do të hartohet në mënyrë analitike me të cilin rast do të japim vërejtje më serioze. Sa i përket të hyrave në tremujorin e parë kemi rezultate pozitive dhe të hyrat janë në nivel të duhur, kurse mos realizim kemi vetëm tek lejet ndërtimore, por sezona është e tillë dhe nuk ka realizim të mjaftueshëm. Unë po e shoh se tash ka filluar me të madhe ndërtimi, kurse dokumentacioni përgatitet përpara dhe nuk e di sa ka arsye ky mos realizim? Mirëpo kësaj radhe pa atë pjesën sintetike ku do të shihen shpenzimet për mallra dhe shërbime më detalishtë e përkrahim raportin.

Arben Malqi- edhe grupi i jonë e përkrah këtë raport tremujor, sepse drejtori shumë mirë e elaboroi, i cili theksoi se për shkak të mos aprovimit të buxhetit nuk ka pasur mundësi të bëhen shumë gjëra. Mirëpo këtu gëzon fakti se të hyrat vetanake nga taksa dhe biznesi dhe nga taksat komunale është tejkaluar përqindja. Gjithashtu edhe unë pajtohem me folësin paraprak, sepse tek lejet e ndërtimit e shoh një mangësi dhe është një rezultat më i vogël, por megjithatë jemi të kënaqur.

Arben Mehmeti-unë kam vetëm pyetje. Cila është arsye e planifikimit joadekuat në raport me realizimin për shkak se edhe nëse kemi ngritje 136%, cila është arsyeja e planifikimit joadekuat? Kjo ka ngjarë tek biznesi, tek të hyrat e kulturës 141%. Duam një arsye ku qëndron ky dallim i mos disproporcionit? Tjetër është cilat janë arsyet pse nuk figurojnë gjobat e gjykatave? Këto gjoba nuk janë as të planifikuara, por as të realizuara, po ashtu është edhe tek të hyrat nga Agjensioni Pyjor i Kosovës. Gjithashtu e kemi një donacion prej 20 mijë eurove, për çfarë donacioni bëhet fjalë?

Riad Rashiti- ne e përshëndesim këtë raport dhe i urojmë punë të mirë, sepse po arrijmë me sukses për ta përmbushur planifikimin dhe shihet se realizmi është 92% i cili është një sukses i mirë. Ne përkrahim këtë raport.

Nuhi Nuhiu- sa i përket pyetjeve që i bërë z. Abdyl Aliu pse ky raport t' i ketë vetëm 4 faqe e jo më tepër, për të cilën pyetje po them se duhet të dallohet raporti 1 vjeçar nga ai tremujor.

Raporti 1 vjeçar paraqitet në mënyrë analitike, kurse këtu është në formën sintetike. Unë e thash se planifikimi nuk ka pasur mundësi të paraqitet në këtë raport për shkak të mos aprovimit të buxhetit nga Qeveria e Kosovës. Ne nuk mund të paraqesim planifikim derisa nuk aprovohet një buxhet.

Analitikë nuk kemi pasur mundësi të japim, por këtë do ta keni në gjashtëmujor ose nëntëmujor.

Lidhur me pyetje e Arbeni pse kemi disproporcion me planifikim dhe realizim? E kemi për atë se ne si drejtori kemi marrë masa që subjektet afariste të cilat nuk i kanë kryer obligimet, me vite të tëra, që nga viti 2000 e deri më tani, atyre përveç aktvendimeve që i kemi dorëzuar për taksë komunale, ne edhe në vërejtje e kemi shënuar sa e ka obligimin si subjekt afarist. Kjo masë ka ndikuar që qytetarët tash po kryejnë edhe obligimin paraprak, por duhet ditur se tash qytetarët, ditë-ditës po vetëdijesohen dhe janë duke i kryer obligimet.

Mandej përsëri tek planifikimi joadekuat të Kultura, Rinia dhe Sporti ne nuk mund të planifikojmë aty të hyra, sepse ata merren me aktivitete, por në ndërkohë krijohen disa të hyra.

Gjobat nga gjykata nuk mund të planifikohen dhe këto gjoba na vijnë diku në qershor, kurse gjobat në trafik në çdo muaj na paraqiten në raport financiar.

Donacioni i cili u përmend, ajo nuk është e hyrë e jona, por është nga donatorët dhe nuk e paraqesim si të hyrë vetanake, sepse ajo ka qenë prej UNDP-së.

Gjithashtu edhe tek Agjensioni Pyjor ne nuk mund të bëjmë planifikim se sa do të kemi inkasim nga ata.

Abdyl Aliu- me gjithë ato që u thanë është një fakt që nuk mund ta mohojë askush. Shpenzimet kanë ndodhur, veturat i kanë bërë kilometrat, drekat dhe darkat janë ngrënë. Ka qenë desh të

paraqitet rekapitullimi i shpenzimeve sipas kodeve ekonomike. Mirëpo tash si e tha drejtori raportin tjetër e marrim vetëm për tre muaj vijues dhe nga kjo shihet se këto do të kalojnë për pa u parë se sa është harxhuar karburante në tremujorin e parë.

Izmi Zeka- ju z. Abdyl, mund të shkoni në drejtori dhe kërkonti çka të iu interesojë, kjo nuk mbyllet këtu, prandaj edhe në mënyrë analitike mund t' i kërkonti këto gjëra?

Qeamjl Mustafa- ne po të bëjmë krahasime me vite në vitin 2010 , në krahasim me atë 2009 ishte më mirë, por këtë vit në krahasim me vitin 2010 është shumë më mirë. Ky është progresi, por ne mund të debatojmë në frymën e asaj se a ka pasur mundësi të jetë edhe më mirë, por edhe çka mund të debatohet për të qenë më efektiv dhe më dinamik.

Është punë e mirë ajo çka po ndodh në Drejtorinë Financave duke i kuptuar me disa të meta të cilat e përcjellin këtë fazë. Së pari po iu them se ju keni të drejtë në secilën kohë të qaseni në secilën drejtori, në secilin sektorë, zyre etj. Ju i keni adresat elektronike dhe aty mund t' i adresoni çështjet, kurse këta janë të obliguar për t' iu servuar të dhënat e kërkuara. Nëse dikujt i intereson se çka ka ndodh brenda një kodi, urdhëroni dhe në një kohë rekorde, ata janë të obliguar t' iu japin përgjigje. Sa i përket tejkalimeve të cilën çështje e ngriti Arbeni, po iu kujtoj se ne e kemi miratuar buxhetin me 3.5 milion euro dhe nëse ky trend vazhdon i cili do të vazhdojë tash shumë më mirë në muajt e verës do të bindemi se këto tejkalime kanë me qenë larg më të mëdha.

Tendencë e jona është që ta mbërrijmë atë limitin prej 3.5 milion euro, kurse këtu po flasim për të hyrat e planifikuara prej 3 milionëve. Nëse këtë e realizojmë ne do të dalim me afër 15 ose 20% mbi planifikimin.

Ne jem të hapur për të gjithë, urdhëroni adresoni çështje dhe do të merrni përgjigje!

Numri i kërkesave që ju i keni adresuar në KK- është shumë simbolik, tek kryesuesi, te kryetari i Komunës për të marrë përgjigje është tepër simbolik.

Nevzad Rushiti- kërkoj një sqarim nga drejtori i Financave? Mendimi im është se te tatimi në pronë realizimi është më i miri, por nuk e di si qëndron puna te objektet afariste të cilat punojnë sa e kanë çmimin për m² dhe ato objekte afariste të cilat nuk punojnë? Nëse është çmimi i njëjtë unë nuk do të isha pajtuar me këtë?

Izmi Zeka – këto gjëra i ke në rregullore dhe aty i gjen të gjitha.

Zijadin Maliqi- lidhur me atë që tha drejtori që në tremujorin do t' i keni të dhënat pa tremujorin e parë po e them se nuk është mirë ashtu. Sa i përket planifikimit të hyrave për mua nuk është e arsyeshme të paraqiten në këtë formë, sepse planifikimi i të hyrave bëhet për një vit dhe jo për tre muaj?

Nuhi Nuhiu- unë kam menduar ta jap një raport të shkurtër sintetikë, por ai më doli analitikë. Mua më vjen mirë që debatohet dhe nga reagimet po vërej se është bërë punë.

Sa i përket pyetjes së Nevzadit, është e vërtetë se tatimohen lokalet që e kanë 017, kurse ato që nuk janë funksionale, ato llogariten si depo dhe e kanë 0.08% normën tatimore.

Sa i përket asaj që e thotë Zijadini, pse raporti nuk është bërë në mënyrë analitike, unë po përsëris se raporti në mënyrë analitike bëhet ai njëvjeçar.

Izmi Zeka - është një realizim dhe planifikim prej 92%, planifikim dhe realizim i duhur. Këtu ka lëvizje, por kryesorja kemi arrit që ta realizojmë atë çka është planifikuar. Edhe unë e kam një bindje se fundi nuk do të jetë nën 3.5 milion euro.

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesi kërkon që të aprovohet ky raport tremujor

Aprovohet Raporti financiar për janar - mars 2011 me 30 vota të anëtarëve të kuvendit, 1 ishte abstenim

3. Informatë për manifestimin “Flaka e Janarit” 2011,

Izmi Zeka- të gjithë këshilltarët informatën e kanë marrë së bashku me materialin, kurse drejtori t’ i dëgjoj sugjerimet dhe vërejtjet, kurse fjalën në fund e merr drejtori.

Selver Xhelili- tek raporti financiar te mbledhja e shifrave është një gabim teknik në total 72887, por duhet të jetë 77.887 euro

Mimozë Kadriu- unë pajtohem me rëndësinë dhe vlerën që e ka manifestimi “Flaka e Janarit”, sepse ky manifestim i jep një famë këtij qyteti, por është edhe manifestim i cili është bërë tradicional. Mirëpo edhe përkundër kësaj unë shprehi shqetësimin lidhur me buxhetin i cili është shpenzuar për organizimin e këtij manifestimi. Unë mendoj se ndoshta gjysma e tyre nuk ka pasur nevojë të ndodh duke i pasur parasysh akomodimin, aktorët të cilët janë sjell nga Shqipëria dhe qytetet e tjera të cilët kanë qëndruar me javë nëpër hotele të Gjilanit.

Ne e kemi një Teatër profesional, i kemi ansamblet kulturore, kemi artistët të cilët posedojnë vlera dhe besoj se gjithçka kishim mundur ta realizojmë si duhet dhe do të kishim pasur mundësi për ta kursyer buxhetin. Si shembull për kompensim të aktorëve janë shpenzuar mbi 11 mijë e 700 euro, gjithashtu për fjetje, akomodim dhe dreka dhe darka mbi 27 mijë euro. Shpërndarja e mysafirëve është bërë në 4 hotele të Gjilanit, por në hotelin “Kristal” nuk janë pasqyruar shpenzimet sikur tek restaurat “Luli” dhe të tjerët.

Vërejtje tjera ka lidhur me gupet punuese për organizim të këtij manifestimi, sepse aty ka emra të përfaqësuesve të partive politike, por herëve të tjera ju lus që ta nderoni dikë, sepse Gjilani ka edhe figura të tjera që i kanë dhënë shumë këtij vendi. Nuk jam kundër këtyre njerëzve, por ka edhe të tjerë që kanë pasur mundësi të jenë përfaqësues të jurisë ose grupeve të tjera.

Shpresë Kurteshi- unë po flas në emër të grupit të këshilltarëve të LDK-së dhe duke e ditur rëndësinë e manifestimit “Flaka e Janarit” dhe arsyeja pse ndodh ky manifestim është nderimi ndaj dëshmorëve tanë. Por unë nuk mund ta kuptoj se si ka mund të ndodhin të gjitha këto shpenzime dhe fare këto shpenzime nuk po e shqetësojnë DKRS-në. Unë e kam të qartë se ky shpenzim i madh i kufizon mundësitë për të financuar projekte të tjera me mjaft vlerë për sport dhe kulturë në Gjilan. Shpenzimet nëpër hotele dhe restaurante i tha Mimoza me të cilën pajtohem, por kam një pyetje se sa ka qenë shuma e mjeteve të planifikuar për këtë manifestim, a është tejkaluar kjo shifër, apo janë shpenzuar më pak se sa janë planifikuar? Gjithashtu kërkojmë për ta ditur zyrtarisht se kush ka qenë anëtarë i bordit të këtij manifestimi?

Abdyl Aliu- drejtori e shtyri shifrën prej 72 mijë euro në 77 mijë, por mos u habitni nëse unë e shtyj këtë shifër në një shumë mbi 157 mijë euro! Kjo është reale 157 mijë e më tepër euro janë shpenzuar për “Flakën e Janarit” dhe jo 77 mijë euro. Mua më brengos fakti se është gjetur një gabim prej 2 mijë eurove dhe nuk është gjet ai prej 70 apo 80 mijë eurove!

Në vijim të fjalës së tij z. Aliu këto gjëra i paraqiti në bazë të tabelës së raportit financiar, duke dhënë shumë gabime të tjera në tabela dhe kur u mblodhën të gjitha të dhënat dolën që të jenë mbi 157 mijë euro shpenzime për këtë manifestim.

Kjo është për të brengos, por jo vetëm kjo, por edhe raportet e tjera të kësaj drejtorie.

Kam dallime në çmim në mes restaurantëve si p.sh. te “Luli” 6.5. euro në tjetër restaurant 12 euro i cili është dallim shumë i madh. Sipas kësaj që kam vërejtur del se “Flaka e Janarit” është një rast i mirë për përfitime. Një pyetje për drejtorin, sa mjete janë planifikuar për “Ditët e Agimit” ?

Rashit Sahiti- unë kam një pyetje për drejtorin. A nuk ka pasur moderatorë në Kosovë që dinë të flasin shqip, por e morët një në Shqipëri vetëm për t’i dhënë para?

Edhe në gjë po e them kjo shumë aq e madhe e mjeteve të shpenzuara, a do të na mjaftonte për të bërë ne të gjithë dasmë dhe për ta bërë edhe një martesë?

Tahir Arifi- unë e di që thuhet në popull “se secila kërrabë ngreh nga veti dhe asnjë nuk shtyn”.

Unë në këtë Kuvend me ëndje e dëgjoj Zijadin Maliqin kur flet për raportet financiare, kurse te grupi im e përcjelli Riadin dhe do të dëshiroj që të kemi konsideratë për njerëzit që merren me profesione të ndryshme. Ata njerëz fushat të cilat nuk i njohin, më mirë është t’i dëgjojnë ata që i njohin. Kam disa vërejte për drejtorin, sepse me sa e di unë raporti nuk ka kaluar nëpër komitete dhe ka ardhur direkt dhe nuk e di pse ka ndodhur kështu?

“Flaka e Janarit” është identiteti kulturor i Gjilanit, këtë duhet ta dini të gjithë, por si të dëshironi ne mund ta shuajmë këtë manifestim dhe pastaj mbetemi me këto punët e vogla.

Ne në vazhdimësi kemi synuar jo për ta mbyllur atë, por për ta bërë një institucion shumë të rëndësishëm të kulturës i cili do t’i përfshinte vlerat kulturore dhe artistike të tërë hapësirës shqiptare. Kemi synuar gjithherë për ta ngrit edhe në aspektin cilësor dhe përmbajtjesor në kuptim e pjesëmarrjes së artistëve eminent të hapësirës gjithë shqiptare. Ky manifestim gjithnjë ka ardhë duke u përmirësuar dhe të gjithë janë pajtuar me këtë. Unë do të dëshiroj që kur të flasim për këtë manifestim disa kolegë të mi së paku të jenë pjesëmarrës në ndonjë manifestim.

Shifra ka shkuar në 77 mijë euro, por një shfaqje teatrore kushton 70 mijë euro, kurse ne po flasim për një manifestim i cili i ka 4 shtylla kryesore të artit. Ka një festival të dramës, ka konkurs letrar, orë letrare dhe koncerte muzikore të zhanreve të ndryshme. Me një fjalë i ka të gjitha fushat e zhanreve të ndryshme të artit. Unë jam në pajtim se këto mjete janë shumë për Komunën e Gjilanit, por ne duhet të bëjmë përpjekje për ta rrit buxhetin dhe vitin e ardhshëm ta bëjmë më mirë.

Bordi absolutisht nuk ka qenë politik, por shumica e tyre kanë qenë pjesë e Flakës dhe shumica e atyre që kanë qenë të interesuar për të kontribuar në organizmin e këtij manifestimi.

Tek shifrat kemi bërë gabime teknike, sepse shumat duhet të jetë ajo dhe unë 20 ditë kam punuar në këtë manifestim dhe i kam marrë 250 euro, nëse më pyet a do të punosh 20 ditë për 250 euro nuk do të kisha pranuar kurrë.

Arben Mehmeti- ka qenë kërkesë e LDK-së për të na pajis me informata shtesë për këtë raport, sepse në seancat e kaluara e kemi pasur një raport i cili absolutisht nuk i përket një raporti. Tash e kemi marrë një raport i cili është më serioz, por përsëri është skandaloz në bazë të shifrave që janë paraqitur këtu. Ne nuk e dimë cilat janë gabimet teknike në këtë raport, duhet të jetë përgjegjësi dhe duhet të japin përgjegjësi ata të cilët e kanë bërë këtë raport me këso gabime skandaloze.

Është gabim i rëndë të gabohet për 70 mijë euro në një raport. Ne kemi kërkuar edhe informatë shtesë nga drejtori, por ai nuk i ka ofruar përsëri, ne kemi kërkuar specifikim të çdo centi që është shpenzuar aty, sepse ky është manifestim shumë i rëndësishëm për Gjilanin. Ne mendojmë që përmes DKRS-së që t’i propozojmë ministrisë përkatëse që ata të planifikojnë buxhet shtesë dhe kjo të jetë një manifestim tradicional i Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport për ta na përkrah ne këtë barrë e cila është mjaft e rëndë për Gjilanin. Z. Tahiri shumë gjëra i tha të cilat qëndrojnë, por është mirë që komiteti zyrtarisht t’i drejtohet Ministrisë së Kulturës, sepse drejtori po shihet se nuk ka kapacitete për ta bërë këtë.

Kërkoj nga drejtori që në grupin punues të artit pamor në të cilin grup janë tre anëtarë, prandaj dua ta di nga sa janë kompensuar këta anëtarë të grupit?

Këtu kemi edhe njerëz të shpërblyer, por ka raste kur dikush ka qenë edhe juri edhe e ka shpërblyer veten dhe për mua është jo serioze edhe pse ndoshta e ka merituar?

Arti skenik e ka grupin punues në të cilin janë Ali Demi dhe Shkëlzen Berisha të cilat persona i përkasin teatrit, prandaj këtu ka qenë desh të përfshihen njerëz të artit skenik që nuk e menaxhojnë këtë manifestim.

Në fund të raportit thuhet se juria shpërbleu 10 trupa dhe individ. Kërkojmë për të na njoftuar se cilët trupa janë dhe cilët individ?

Te arti letrar thuhet janë shpërblyer 6 individ, tre në poezi dhe tre në prozë, prandaj i kërkojmë emrat e atyre që janë shpërblyer në poezi dhe cilët në prozë?

Tek arti muzikor për mua është joserioze kur prej një familje shpërblehen dy anëtarë dhe kjo është një jo seriozitet dhe në këtë mënyrë mund të ndihen të fyer një pjesë e madhe e njerëzve që merren me kulturë.

Gjithashtu thuhet se janë shpërblyer më të dalluarit, por do të ishte mirë të na thuhet se cilët kanë qenë ata aktivistë?

Te burimet financiare thuhet se Zyra e kryetarit të Komunës e ka bërë financimin, por nuk e kemi shifrën e atij financimi? Gjithashtu duhet specifikuar financimet, sa janë nga kryetari, drejtorja, ministria dhe sa prej donatorëve të ndryshëm.

Të na thuhet për anëtarët e bordit kush janë me emra dhe mbiemra?

Të na epen emrat e të shpërblyerve në artin pamor 3, në atë skenik 10, në arin letrat 6 etj të cilat gjëra u thanë edhe më parë.

Arben Maliqi- dëgjova shumë kritika ndaj drejtorit dhe nuk pajtohem me juve, sepse drejtori nuk është fajtor dhe këtë po e them shumë sinqerisht. Mirëpo kjo shumë 77 mijë euro e kam thënë edhe në KPF është e madhe dhe e jashtëzakonshme. Këtë po e them prej pozitës që ka transparencë dhe do të ketë nga PDK e cila me të vërtetë shprehë transparencë dhe nga kolaiconi do të ketë gjithmonë. Mirëpo nuk pajtohem me Mimosë Kadriun e cila theksoi se PDK e ka bërë, pajtohem me të gjitha, por jo me atë se vetëm PDK ka marrë pjesë. Fillimisht duhet përshëndetur këtë punë e veçmas kryetarin e Komunës, sepse kjo është bërë nën patronatin e kryetarit të Komunës. Çdo gjë që bëhet për njerëzit e merituar që nga Skënderbeu deri tek lufta emblematisht e UÇK-së, sepse çdo gjë që bëhet për ta është shumë e mirë dhe e ndershme dhe borxh ia kemi. Mirëpo vërtetë ky qytet nuk e ka atë kapacitet për ta bërë tërë këtë bujë, për t' i sjell njerëzit dhe artistët më të njohur nga Shqipëria dhe të gjitha trojet shqiptare për këtë manifestim. Janë disa shuma që për mua nuk janë të arsyeshme aspak. Nisja e trupave nga Prishtina, Fier, Shkodër 3300 euro, për artistët mbi 11 mijë euro, te "Kristali" mbi 10 mijë euro, Restaurat "Luli" afër 11 euro, "Luxsori" 6 mijë, këto me të vërtetë janë shuma të mëdha. Ne sikur ta kishim menduar edhe gjysmën e kësaj shume edhe për 21 aktorë, prej të cilëve 9 janë staf i teatrit për disa vite do ta zgjidhim këtë problem. Unë jam që "Flaka e Janarit" të mbahet, por për këtë shumë marramendëse, ne nuk i kemi mundësitë. "Flaka e Janarit" duhet secilin vit të freskohet dhe në mënyrë të dinjitetshme të festohet dhe të mendohet për fëmijët tanë, investimet kapitale t' i bëjmë për fëmijët tanë.

Mimosë Kadriu- sa i përket organizmit unë po e kuptoj se nuk e keni bërë organizmin bash si një koalicion, por për dështimin që kemi bërë je përgjigjes edhe ti, sepse përfaqësimi i grupeve punuese janë anëtarë të PDK-së. Për dallim nga ne që vazhdimisht kemi qenë të kthjellët ju nuk po liroheni nga turbullira e koalicionit!

Riad Rashiti- unë dëgjova shumë vërejte dhe disa për mua janë të arsyeshme, kurse disa të paarsyeshme, por po lidhem me fjalën e Abdylit i cili e quajti alarmante gjendjen e shpenzimeve.

Në vijim të fjalës së tij z. Rashiti e arsyetoi tabelën e shpenzimeve në të cilën kishte pasur mjaft gabime teknike. Në përgjithësi ky ka qenë një manifestim mjaft i mirë dhe kam një propozim që herëve tjera të përfshihet edhe festa e Ditës së Pavarësisë me një projekt të përbashkët.

Abdyl Aliu- me siguri nuk jam përcjell mirë kur kam folur nga kolegu Riadi, nuk ka kalkulator tjetër që qet tjetër shifër përveç asaj 157 mijë e 182 euro. Në vijim të fjalës z. Aliu i përsërit tabelat e shpenzimeve

Qemajl Mustafa- së pari po iu them se ju e keni pasur një raport kështu, por me të cilin nuk jemi pajtuar që është i mjaftueshëm, prandaj qëndrimi ka qenë që ai raport të jetë më analitik.

Shifra atëherë ka qenë korrekt siç u tha nga drejtori sot 77887.

Pajtohem plotësisht me atë qëndrimin kritik të këshilltarëve që raporti është i punuar dobët teknikisht, por më vonë ka dalë që të ketë edhe refleksione përmbajtjesore, në kuptimin negativ të fjalës. Së pari duhet drejtori në post elektronike t'ia u përcjell më së voni deri në fund të kësaj jave, raportin detal me të gjitha kërkesat që ju i shtruat këtu.

Që nga momenti i themelimit të Bordit të “Flakës së Janarit”, emrat në atë bord, secili çfarë roli ka pasur, trupave punues dhe liderëve të atyre trupave punues etj.

Se cili pozicion në grupet punuese ka qenë i shpërblyer me mjete materiale, por ka pasur mëditje dhe shpenzime të tjera, prandaj kjo duhet të jetë në raport.

Sarandë Bllaca- në fillim e kam një pyetje të vogël, për drejtorin dhe jo për të gjithë anëtarët e PDK-së të cilët filluan të përgjigjen. Pyetja ka të bëjë me atë se ne anëtarët e Kuvendit nuk kemi pasur asnjë ftesë për pjesëmarrje në “Flakën e Janarit”, por nuk e di a është informuar për këtë drejtori, sepse unë personalisht nuk e kam marrë asnjë ftesë, por as të gjithë kolegët me të cilët kam biseduar. Në këtë mënyrë ne nuk kemi pasur të mundësi të shohim asnjë shfaqje pa ftesë. Unë mendoj se kjo është një papërgjegjësi shumë e madhe, sepse ne po debatojmë që një orë, kurse nuk kemi qenë pjesëmarrës, kjo të mbetet për ta vlerësuar?

Shpresë Hajdari – unë po e them se “Flaka e Janarit”, është mbajtur në një përudhë kohore mbi 20 vjeçare e cila ka pasur një ndërprerje gjatë luftës dhe ka pasur vështirësi në forma të ndryshme, por përsëri është mbajtur nuk është shpëputur. Është manifestim tradicional që duhet të mbahet.

Sa i përket këtij viti me të vërtetë ka qenë vit Jubilar, por duhet thënë se ka pasur një akomoditet pak më të madh, ka pasur mundësi të mos harxhohen tërë ato mjete, por megjithatë është mbajtur.

Ne krenohemi me këtë manifestim që kemi dhe unë pajtohem që edhe Ministria ta ketë kalendarin e vetë për një festë të tillë pasi që është i vetmi manifestim i tillë në Kosovë.

Revista “Agmia” e cila është tradicionale për të cilën shihet se është një shumë e madhe e mjeteve dhe ka tirazh të mjaftueshëm, por edhe neve këshilltarëve duhet të na jepet në dorë nga një revistë e tillë. Kam edhe një propozim tjetër, sepse kisha pasur dëshirë që në qytetin e Gjilanit të bëhet edhe kalendari i festave të qytetit të Gjilanit. Në këtë mënyrë do të kishim pasur mundësi për të parë se cilat festa vlejnë të shënohen, apo të hiqet dhe thjeshtësohet ky kalendar?

Elisah Ymeri- unë nuk kam çka të them pas fjalës së kryetarit, pos ta falënderoj drejtorin për hir të angazhimit që ka bërë për këtë manifestim dhe në veçanti e falënderoj z. Tahirin për angazhimin tejet të madh që ka bërë për këtë manifestim. Mirëpo në veçanti i falënderoj nismëtarët e Flakës së Janarit, të cilët e kanë iniciuar, sepse kjo jo vetëm që është tradicionale, por në një të ardhme do të jetë edhe simbol i qytetit të Gjilanit.

Lidhur me shpenzimet, po vërej se dikujt po i duken shumë, por unë mendoj se këto janë të arsyeshme, por mund të jenë edhe më të mëdha për këtë manifestim.

Të vetmen vërejtje e kam nëse shpenzimet janë të fryra siç është rasti te restauruat “Luli” ku del se një drekë kushton 6.5 euro. Unë konsideroj se tek kjo vërejtje duhet të ndalemi dhe mos të jenë shifrat e fryra, ndërsa sa do që të jenë shpenzimet e mëdha “Flaka e Janarit” është simbol i yni.

Ejup Haziri- unë së pari po them se unë nuk vuaj nga ajo epidemia e fjalamanisë dhe zakonisht këto seanca po na stërzgjaten nga dëshira për të folur shumë, prandaj është më mirë për të pasur cilësi. Debatin për “Flakën e Janarit” e kisha ndarë në dy dimensione. Ato dimensione janë, ai artistik dhe ai teknik. Me dimensionin artistik janë të kënaqur të gjithë, sepse këtë vit e ka pasur një dimension i cili e ka përfshirë tërë hapësirën shqiptare. Vërejtja e ime është se herëve tjera është që ta krijojmë një dimension më të vogël për artistë në nivele lokale që i kemi. Dimensionin tjetër është ai teknik po e krahasoj me atë se nëse në autoudhë hynë në ndonjë trase të gabuar, puna më e mirë është të kërkosh dalje dhe të hysh në trasenë tënde. Në dimensionin teknik, në raport unë pajtohem plotësisht me ato që u thanë dhe i preferoj kryetarit të Komunës që t’i zbatojë nganjëherë ato dënimet e gabimeve teknike të cilat zbatohen në basketboll.

Një vërejtje edhe unë e kam për drejtorin, sepse me të vërtetë raporte të tilla nuk guxojnë të dalin.

Sadudin Berisha- nuk do të flas për koston financiare se sa ka kushtuar ky manifestim, por do të ndalem në disa çështje të cilat përfundimisht do të duhej të skeletohen si duhet, për këtë manifestim i cili këtë vit ka qenë vit jubilar. Që nga momenti i themelimit ky manifestim nuk është kualifikuar si manifestim lokal, por gjithë shqiptar. Komuna e Gjilanit në dy dekadat e fundit në trojet shqiptare njihet pikërisht përmes “Flakës së Janarit”. Kujtoj se barra financiare dhe organizative nuk do të duhej përfundimisht t’i bie gjithë Gjilanit, për derisa aderojnë artistët e tërë trojeve shqiptare.

Këtij raporti i mungojnë dy elemente kryesore. Është i shkapërderdhur shumë, nuk e kemi skemën organizative dhe koston e realizimit të asaj skeme organizative, sa është planifikuar, sa është realizuar? Nëse do ta kishim atë qartësimi do të ishte më i mirë dhe më i qartë, ne nuk e kemi këtë skemë dhe kjo është arsyeja pse kaq gjatë debatohet.

Ne nuk kemi nevojë për këtë informatë, por drejtorja duhet të na jep raport.

Tahir Arifi- unë jam i ndjeshëm kur flitet për kulturën ashtu sikur dikush që është i ndjeshëm kur flitet për barazinë gjinore. Në kulturë gjërat maten me prodhimtarinë kulturore sa është ajo cilësore dhe zakonisht njerëzit që merren me kulturë nuk brengosen shumë për shifrat, sepse atyre iu intereson për ta bërë punën mirë. U tha se “Flaka e Janarit” këtë vit ka arrit të bëhet ashtu si duhet dhe unë nuk do ta fajësoj aq shumë drejtorin, sepse te kultura nuk merren shumë me shifrat dhe ekonomia.

Për punën e bordit u tha diçka, por ato kanë qenë ekipe profesionale, kurse në grupin punues kemi qenë unë, Xhevat Latifi dhe Sabit Rustemi, ne e kemi bërë jurinë dhe juria i ka përzgjedh të tjerët.

Për Ditët e Agimit që u përmend, fshati Zhegër së bashku me Drejtorinë e Kulturës do të shpenzojnë aq sa ka nevojë dhe kështu ka ndodhur në dy manifestime ku unë kam qenë pjesë e organizimit të këtij manifestimi.

Selver Xehlili- unë i dëgjova të gjitha kritikën të cilat m’u adresuan mua si drejtor, mirëpo desha të lidhem tek çështjet teknike të shifrave. Ju kujtoj se unë e kam sjell raportin financiar në të cilin kanë qenë të gjitha të dhënat dhe aty kanë qenë 77887 euro dhe prapë unë e kam dërguar te sekretaria, por ky gabim është në mbledhje të shifrave. Ky nuk ka qenë gabim teknik i drejtorisë, kurse sa i përket anës drejtshkrimore në anën teknike është ashtu siç ka ndodh në këtë manifestim.

Unë po i vërej disa kritika që po bëhen në Drejtorinë e Kulturës, por ndoshta në këtë drejtori nuk ka ndonjë interes, si opozitë për t’i punësuar familjarët e juaj dhe lokomotivë e këtyre kritikave është Arben Mehmeti i cili po i bën disa kritika të pa baza. Unë si drejtor jam i gatshëm të jap llogari për

çdo euro e cila është shpenzuar për “Flakën e Janarit” dhe të jap përgjegjësi për këtë dhe këto i them me përgjegjësi të plotë.

Arben Mehmeti- unë asgjë nuk kam thënë jashtë asaj që i tërë Kuvendi e konstatoi si një raport të dobët, një punë jo profesionale, prandaj unë nuk jam lokomotivë, por të gjithë ata që debatuan duke përfshirë edhe kryetarin konstatuan parregullsi.

Izmi Zeka- Unë edhe njëherë kërkoj nga drejtori i Drejtorisë me tërë kërkesat që i patën këshilltarët, t’ i dërgohen në adresa elektronike duke i përmirësuar të gjitha vërejtjet të cilat janë dhënë. Me këtë përmbillet ky informacion i plotë.

Nuk pati debatues, të tjerë për këtë informatë, kurse në ora 14 këshilltarët kërkojnë një pushim prej 1 ore i cili pushim mundësohet nga kryesuesi .

Seanca vazhdon punimet në ora 15.20 min.

4. Propozim-vendimi për shpalljen e Interesit publik për shpronësim të paluajtshmërive për rregullimin e infrastrukturës rrugore në Komunën e Gjilanit,

Izmi Zeka- të gjitha pikat në vijim të pjesës së dytë të seancës kanë kaluar në Komitetin për Politikë dhe Financa, por kanë kaluar edhe në kolegjin e grupeve politike, prandaj tash mund të bëhet vetëm ndonjë sugjerim, apo vërejtje.

Aprovohet unanimisht pika e 4 e rendit të punës

5. Propozim vendimi për përkrahjen e krijimit të Zonës Ekonomike me Komunën e Novo Berdes,

Izmi Zeka- kjo është një zonë ekonomike për të cilën dy kryetarët e këtyre komunave kanë nënshkruar Marrëveshje mirëkuptimi për të qenë një zonë ekonomike e përbashkët me Gjilanin dhe Novo Bërdën. Siç thash më parë ky propozim- vendim ka kaluar në KPF, por nëse ka ndonjë vërejtje mund ta thoni.

Ramiz Ramadani- në materialin që e kemi marrë nuk kam mundur në asnjë mënyrë ta gjejmë interesin e qytetarit të Gjilanit. Pyetja e ime është, cili është interesi i qytetarëve të Gjilanit në atë zonë ekonomike? Cili është interesi i bizneseve të Gjilanit? Cili është statusi i këtyre bizneseve nëse zhvendosen në atë zonë ekonomike? Kujt do t’ i paguajnë kontribute dhe tatime këto biznese? Dhe në fund dëshiroj për ta ditur se a keni menduar që Gjilani të ketë ndonjë park industrial ose zonë ekonomike? Apo zgjidhje i konsideroni këto që bizneset t’ i zhvendoseni në një zonë ekonomike në Zabel.

Izmi Zeka- me këtë çështje më tepër është marrë Fadil Osmani, zyrtar për projekte, por ky është një interes i dy komunave dhe kjo është vërtetuar, sepse këtu do të ketë edhe donatorë dhe financues të tjerë. Interes direkt nuk do të ketë shumë Gjilani, por është një zonë e përbashkët, kurse sa i përket parkut industrial, ne e kemi planifikuar i cili mund të mos jetë në standarde të larta.

Kjo ka të bëjë me interes të dy komunave, por ndoshta interesi do të jetë më i madh i Novo Bërdës, por në mënyrë indirekte edhe Gjilani përfiton.

Është mirë që pasi që është bërë Marrëveshja që ky propozim të kalojë dhe nëse ka nevojë mund të japim edhe informacione shtesë në seancat e ardhshme.

Ejup Haziri- unë po tregoj arsyet pse e kemi përkrah. Ne vetëm nëse e krahasojmë tregun kafshëve në Gjilan dhe aty në Llabjan, aty ku është kjo qendër, mund të vijmë në një përfundim që për bizneset gjilanase aty krijohet një biznes më i madh se sa është në Gjilan. Dobia shihet, unë e mora shembull vetëm tregun e kafshëve, sepse po e afrojmë një treg mes dy qendrave të mëdha asaj të Prishtinës dhe Gjilanit.

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesi kërkon që të aprovohet kjo pikë e rendit të punës

Aprovohet pika 5 e rendit të punës me 30 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse 1 ishte kundër

6. Propozim-Statuti i Teatrit Profesionist të Qytetit të Gjilanit,

Tahir Arifi- unë kam qenë pjesë e debateve për Statutin e Teatrit i cili rast ka kaluar edhe tek Komisioni statutar i Komunës, pastaj është bërë edhe një punë shtesë dhe gjithçka ka ndodhur mirë sa i përket harmonizimit të këtij statuti.

Mirëpo, unë i kam disa vërejtje; në nenin një mjafton të jetë Teatri i Gjilanit, nuk ka nevojë fjala profesionist as e qytetit, kurse shkurtesa të jetë TGJ.

Te neni shtatë formulimi duhet të jetë: Teatri është institucion, publik, kulturor dhe nuk ka nevojë të thuhet i pavarur.

Te neni 8.b- në vitin 2002 apo 2003 Teatri ka pasur marrëveshje me një person të cilit ia ka dhënë në shfrytëzim, sepse menaxhues i hapësirë së Teatrit është Komuna dhe janë dhënë në shfrytëzim disa prej pjesëve të Teatrit dhe mendoj do të duhej të jetë kështu: “ mbështetur në marrëveshjen”, mundësisht të gjendet ajo marrëveshje e cila është bërë me Teatri e Gjilanit. Do të thotë mundësisht të gjendet ajo marrëveshje.

Izmi Zeka- mendoj se është mirë fjala profesionist të mbesin, por kjo t’ i mbesin Zyrës ligjore për ta formuluar dhe rishikuar se si të jetë kjo? Profesionist apo Teatri i Gjilanit, kjo t’ i mbesin Zyrës ligjore? I pavarur duhet të hiqet medoemos!

Aprovohet pika 6 e rendit të punës me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit me këto ndryshime

7. Propozim vendimi për themelimin e Trupës Profesioniste Muzikore të Qytetit,

Me vendim të anëtarëve të Kuvendit, pika e 7 e rendit të punës u hoq nga rendi i ditës

8. Propozim vendimi për ndarjen e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës për aftësimin profesional dhe Qendrën e Punësimit

Izmi Zeka – për këtë rast ministria i ka ndarë mjetet dhe kjo tash ka mbetur tek ne për ta përfunduar procedurën

Ramiz Ramadani- unë po e theksoj se po e shoh se përsëri jemi anashkaluar ne Komiteti për Planifikim Urban, sepse për zbatim të këtij vendimi është përgjegjës urbanizmi dhe mendoj se ka qenë desh të shqyrtohet në Komitet për Planifikim Urban, pastaj në atë për Gjeodezi dhe Kadastër, por pasi drejtoresha është këtu unë po pyes a është kjo në harmoni me planin urbanistik ?

Bahrie Mahmuti- ne si drejtori jemi në proces të hartimit të Planit rregullativ të asaj pjese dhe mund të them se ajo do të inkorporohet nga sektori i planifikimit. Nuk mund të them se është në harmoni, por në proces ne do ta fusim.

Aprovohet pika 8 e rendit të punës me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit

Izmi Zeka- nëse materialet herëve të tjera nuk kalojnë në komitete nuk do t' i marrë parasysh dhe do t' i kthejë!

9. Propozim vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01.Nr.5817 për shpalljen Zonë me interes të përgjithshëm publik të ngastrave nr.1961-1 dhe nr.1961-2.

Sadri Arifi- në material e keni edhe një vendim të datës 26.5.2009 për shpalljen e interesit të përgjithshëm të ngastrës kadastrale 1961-1 dhe 1961-2, mirëpo vendimi i parë e ka një gabim, sepse duhet të jetë 4961/2. Ky është një lokacion ku është ndërtuar objekti i “Don Boskos”, por ai lokacion duhet të zgjerohet edhe me disa hapësira të tjera në mënyrë që investimi të vijë ashtu siç duhet. Për këtë arsye është kërkuar plotësimi i asaj pjese me disa lokacione rreth “Don Boskos”. Nëse nuk aprovohet investimet dështojnë.

Shpresë Hajdari- unë kam një pyetje dhe dua ta di se kjo “Don Bosko” sa hapësirë ka dhe për çfarë arsye është e dedikuar, sepse ajo funksion, mbahen disa aktivitete, kurse Komuna përsëri po ia jep edhe një hapësirë. Aty ka hapësirë të mjaftueshme, sepse aty është një sallë më e madhe se ajo e Teatrit. Në fund e kam pyetjen se a do ta shfrytëzojnë qytetarët atë pjesë?

Izmi Zeka – me sa di aty është një sipërfaqe prej mbi një hektar, por nëse këtë nuk e kalojmë këtë, atëherë nuk do të ketë investime.

Ramiz Ramadani- edhe këtë pikë të rendit të punës ne nuk e kemi trajtuar në komitet dhe sikur ta kishim pasur në komitet, unë sot do të isha deklaruar për po ose jo! Por unë nuk e kam shumë të qartë situacionin? Ne kemi një vendim të vitit 2009 në të cilin vendim janë dy ngastra, por i shtohen edhe dy ngastra të tjera të cilat më nuk janë pronë e “Agrokulturës”, prandaj kërkoj që kjo të shtyhet ose kërkoj sqarime prej drejtoreshës se për cilat prona është fjala? Po të i ishn sqaruar këto gjëra në komitet më lehtë ka qenë të merret një veprim final, kurse në këtë formë unë jam mjaft i pasigurt.

Florinë Zymberi- unë e mbështesë Ramizin dhe kjo të jetë hera e parë dhe e fundit, që DUMM, nuk na i sjell neve si komitet këto lëndë, por edhe e lus sekretarinë që me përgjegjësi më të madhe të bashkëpunojë me drejtoreshën që të na i sjellin lëndët këtu dhe të punojmë si duhet.

Unë si arkitekte nuk e di ku gjendet lokacioni, kurse më duhet ta ngris gishtin pse të tjerët e ngrisin gishtin!

Izmi Zeka- prona nuk ka qenë e Komunës, por ne ka qenë desh të bëjmë marrëveshje me AKP-në për ta marrë këtë pronë. Mirëpo edhe njëherë po e theksoj se asnjë propozim tash e tutje nuk mund të kalojë për pa kaluar nëpër komitete. Komitetet duhet të jenë në koordinim me drejtorit e në asnjë mënyrë të na sjellin neve në këtë situatë. Unë nuk mund ta ndali punën në Kuvend dhe t' i bllokojë punët për shkak të mos punës së komiteteve.

Tahir Arifi- unë kam edhe një pyetje. A qëndron “Don Bosko” prapa asaj që përveç aktivitetit socio-kulturor, që aty do të hapet edhe një shkollë dhe që do t' i përfshijë 400 nxënës për teknologji informative?

Izmi Zeka- kjo që po thotë z. Tahri është edhe arsyeja pse është rrit hapësira

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesi propozon që të aprovohet ky propozim- vendim

Aprovohet pika nëntë (9) e rendit të punës me 26 vota të anëtarëve të Kuvendit

10. Propozim vendimi për subvencionimin e qirasë për familjet me gjendje të rëndë ekonomike,

Izmi Zeka- për këtë pikë të rendit të punës fjalën do ta ketë Sadri Arfi, sepse është anëtari i komisionit për këtë çështje.

Sadri Arifi – ju në material e keni një vendim për subvencionim të familjeve me gjendje të rëndë ekonomike, të cilën të drejtë tash na e lejon edhe ligji. Unë e di që komisioni mëparshëm që ka punuar dot ë këtë vërejtje nga anëtarët, por ky Komisioni është formuar me propozim të Drejtorisë së Shëndetësisë të cilin e ka pranuar kryetari dhe që në vazhdimësi është komision i përhershëm dhe merret me shqyrtimin e kërkesave që i drejtohen Drejtorisë së Shëndetësisë dhe i propozon rekomandime drejtorit se çka duhet të bëjë në raste të tilla. Kjo listë prej 21 emrave të propozuar, nga lista e aplikuesve janë 50 familje nga lista fundit, kurse të tjerët janë aplikues nga konkursi i mëparshëm. Po ashtu 5 familje nga këto që propozohen janë 5 familje që kryesohen nga femrat të cilave ose iu kanë vdekur bashkëshortët ose janë të divorcuara prej tyre.

Tri familje për përfitim të qirasë janë henidikepe të kategorive të rënda, kurse 9 familje janë me gjendje të rëndë akute, 5 familje janë përfituese të mëparshme të qirasë nga viti 2010 që është bërë me një vendim të KK-së, por ka edhe familje të ish pjesëtarëve të UÇK-së, kurse njëri prej tyre është i dënuar edhe me 15 vjet burgim në grupin e Gjilanit. Mirëpo prej të gjithë këtyre familjeve 17 janë nga Komuna Gjilanit, kurse 4 nga komunat e tjera.

Sokol Haziri- unë i kam dy vërejte të cilat besoj se janë shumë parimore. E para ka të bëjë me komisionin, sepse ky Kuvend ka zgjedhur Komisionin për çështje të banimit dhe ato sociale dhe ai komision e ka autorizimin për të gjitha çështjet që vijnë në Kuvend për këtë çështje ne duhet të deklarohejmë dhe të vendosim. Kësaj radhe për hir të asaj që këto janë familje skamnore, ne do ta votojmë, por do të ishte mirë që ky komision me mandat të Kuvendit të merret me këto raste, për çështje sociale. E dyta ka të bëjë me atë që ne mos të bëhemi strehë për njerëzit që vijnë nga Kosova Lindore, sepse atje nuk e kemi territorin si komunë, prandaj nuk i kemi as njerëzit.

Sabedin Kadriu- Sadriu na informoi lidhur me këto raste, por do të duhej të dihet për secilin prej nga është dhe ku është i lindur, sepse po ndodh që në Komunë të Gjilanit po bëjmë si të duam?

Vijën njerëz prej tjerave komuna, merr ndihmë sociale prej tjerave komuna, merr banesa dhe pensione! Unë kam punuar në arsim dhe nuk ka asnjë fshat dhe zonë të Komunës së Gjilanit që nuk i njoh mbiemrat. Unë mbiemër Hakuli në Gjilan nuk kam dëgjuar asnjëherë dhe thjeshtë dua ta di kjo Luljetë Hakuli nga cili fshat apo lagje është?

Mua më intereson se ku janë të lindur këta përfitues, sepse mund të ndodh që posedojnë me shtëpia nëpër komuna tjera dhe kam informatë se ka plotë njerëz që jetojnë në Kumanovë, Kamenicë, Bujanoc dhe merr ndihma sociale në Gjilan.

Kërkoj që informata të plotësohet, kurse drejtori ta bëjë edhe një auditim. Kurse për komisionin kërkoj për ta ditur kush e ka propozuar, Kuvendi apo drejtoria?

Rashit Sahiti- edhe unë pajtohem me parafolësit dhe e di se në Komunën tona ka raste të rënda, prandaj është mirë që të hulumtohen edhe rastet tjera dhe të përfshihen, sepse po vërej se nuk janë përfshirë fshatrat fare. Gjithashtu jam që ndihma të jepet për banorë rezident dhe ta dëshmojnë këtë me dokumentacion. U tha edhe më parë se ka njerëz që jetojnë në Turqi, por e shfrytëzojnë

pensionin e Kosovës. Është mirë që këto raste të kihen parasysh dhe të bëhet hulumtimi i këtyre rasteve.

Arben Maliqi- edhe ne e përshëndesim këtë propozim dhe besojmë se nuk është një shumë e madhe prej 50 eurove për një familje. Mirëpo edhe unë kam vërejtje në komision, sepse ne komisionin e kemi dhe unë nuk pajtohem me këto ndryshime. Edhe unë pajtohem me Sokolin që për hir të familjeve të tilla, kjo të kalojë, por ne e kemi komisionin i cili është marrë me këtë çështje.

Mimozë Kadriu- pak është personale nëse flas unë, sepse unë kam qenë anëtare këtij komisioni dhe po i bie sikur po kërkoj për ta vazhduar mandatin tim. Mirëpo kjo po më duket disi e padrejtë, sepse ne i kemi vizituar këto familje që janë në këtë listë dhe i dimë këto raste dhe nuk jemi kundër tyre, sepse e dimë që i meritojnë këto ndihma. Këtu nuk ka ndryshim të madhe, sepse Sadriu dhe Ibrahimimi kanë qenë në komisionin dhe i vetmi ndryshim është Samiu i cili nuk ka qenë në komision. Mirëpo ky komision aktual i shërben Drejtorisë së Shëndetësisë, por çështjet janë të përgjithshme dhe nuk janë vetëm të kësaj drejtorie. Për çështjen e banorëve që nuk janë nga Komuna e Gjilanit, problemi është te kriteret të cilat i ka vendos ministria, sepse aty thuhet se duhet të jetë banorë në 10 vitet e fundit. Ne prej pas luftës kemi fluks të madh nga komunat fqinje dhe në atë aspektin ligjor ato po i përmbushin kriteret, sepse ata kanë dokumentacion. Për këtë që e thash duhet të ndërmarrim diçka dhe të bëjmë ndonjë ndryshim.

Ejup Haziri- dëshiroj që prej banorëve rezident të mos ketë nevojë askush për këso ndihma! Rastet ishin të rënda dhe ato vërejte që u thanë duhet të merren parasysh. Mirëpo ata që e kanë lexuar në brendi besoj se nuk duhet më tepër të debatohet, prandaj kjo është një çështje që duhet të kalojë, sepse kur e verifikon se në çfarë gjendje janë këto familje, njeriu obligohet që edhe personalisht t' i ndihmojë këto raste e mos të flasim për donacion.

Izmi Zeka – që nga dita e sotme, pushon puna e këtij komisioni, nëse është e nevojshme ne si Kuvend e formojmë.

Kryesuesi kërkon nga këshilltarët që ta aprovojnë këtë pikë të rendit të punës

Aprovohet pika 10 e rendit të punës me vota unanime të anëtarëve të Kuvendit

Xemajl Salihu- ne kemi kërkesa të përditshme për këso raste, por edhe unë nuk jam i interesuar për ta marrë mandatin e një komisioni i cili komision ka punuar shumë mirë, por ka punuar për një konkurs për banesa sociale për të cilin rast kanë aplikuar 300 familje. Në atë komision ka qenë një zyrtar për mirëqenie sociale në drejtori i cili merr lëndët brenda ditës dhe e kam angazhuar Ibrahim Salihun i cili është marrë me këto probleme dhe Sadri Arifin. Për mua nuk paraqet problem dhe nuk konsideroj se kam bërë ndonjë lëshim. Ai komision që ka qenë për shqyrtim të kërkesave të qytetarëve për banim social dhe jo për raste që na vijnë brenda ditës!

Izmi Zeka- në nivel komunal, komisioni formon vetëm Kuvendi dhe jo drejtorja dhe që nga dita e sotme i pushon mandati këtij komisioni,

Ejup Haziri- unë deri më tash nuk i kam mbrojt drejtorët, por në rastin konkret, këta e kërkojnë një subvencion prej neve, por përgjegjësinë për të gjitha raste e kanë këta. Unë kisha thënë se me të vërtetë është një punë me përgjegjësi dhe e panderë. Këta i njohin rastet, Ibrahimimi ka punuar me vite në këto raste, Samiu ka qenë me vite të tëra dhe unë e them që këtë komision mos ta prekim dhe le ta vazhdojë punën.

Sokol Haziri- unë dua të jem shumë i qartë dhe unë nuk them se drejtoria nuk ka të drejtë të formojë komisione në kuadër të kompetencave dhe fushë veprimtarisë së vet, mirëpo për çështje që kalojnë në Kuvend, kompetent është Kuvendi për të themeluar komisione. Kjo është e qartë, nuk kemi nevojë të përzihemi në punët e drejtorit, ai i ka punët e veta. Në Kuvend është komisioni për çështje sociale dhe ai duhet ta vazhdojë mandatin.

Arben Maliqi- unë asnjë komision nuk e njoh për pa e pasur përfaqësimin e AKR-së aty! Nuk ekziston për mua ai komision.

Izmi Zeka- për mos ta penguar këtë proces, ne e kemi vendimin e kryetarit të Komunës, por në të ardhmen ky komision duhet të formohet këtu.
Me këtë propozim u pajtuan anëtarët e Kuvendit

11. Propozim vendimi për të drejtat, obligimet dhe përgjegjësit e Komisionit për vlerësimin e aseteve të K.R.M. "Higjiena" në Gjilan, Kamenicë dhe Viti.

Edhe pika e 11 e rendit të punës u hoq nga rendi i punës me vendim të anëtarëve të Kuvendit

12. Strategjia Komunale për kthim të qëndrueshëm dhe ri integrim 2011-2014
Izmi Zeka- materialin e keni nëse ka dikush për të thënë diçka të urdhërojë!

Elisah Ymeri – unë e kam një vërejtje tek pasqyra e kthimit, sepse aty thuhet pas konfliktit 1999, por nuk ka pasur konflikt, por ka pasur luftë të armatosur. Të bëhet ky ndryshim!

Sokol Haziri- një nga çështjet që më ka ra në sy është kjo dhe ne njëherë përgjithmonë duhet të lirohemi nga administrimet fiktive të ndërkombëtarëve në mendjet e disave. Duhet të thuhet luftë dhe jo konflikt, sepse konflikt mund të ketë në mes dy njerëzve në rrugë.

E dyta po them se ne po merremi me disa gjëra që po mendohet se të gjithë i kanë harruar, kurse vetëm ne po merremi me ato. Duhet të ketë Strategji të zhvillimit ekonomik të Komunës së Gjilanit, kurse sa për strategji të tilla të kthimit ku përmendet edhe Parteshi i cili është jashtë Komunës së Gjilanit dhe 12 fshatrave të tjera që përmenden, unë mendoj se nuk kemi shumë kohë për të humbur.

Edhe një të jetë e qartë në këtë strategji, që ne nuk dëshirojmë që të kthehen njerëz të cilët nuk e njohin shtetin e Kosovës. Çdo qytetarë i Kosovës duhet ta ketë dokumentacionin e Kosovës, ta njoh shtetin e Kosovës dhe atëherë t' i gëzojë benificionet e shtetit të Kosovës dhe jo në mënyrë blanko dhe jo si po veprojmë ne, sepse vërtetë është gabim!

Edhe një fakt me parat e tatimpaguesve kosovarë, ndërtohen prona të cila shiten ende për pa u ndërtuar dhe me para të Kosovës veprohet kështu për pa pasur një vizion të qartë dhe unë nuk jam për asnjë lloj strategjie në mënyrë si është servuar sot.

Edhe një gjë si mund të kthehet dikush i cili nuk ka qenë banorë i asaj komune kurrë, mund të kthehet gjithkush në shtëpi dhe pronë të vet askush nuk do ta ndalojë, por jo t' i krijohen kushte dikujt për atë se nuk paska pasur shtëpi kurrë. Këto janë gjëra që duhet të lirohem nga këto komplekse, ne i kemi problemet tona dhe duhet të merremi me veten dhe jo me të tjerët.

Riad Rashiti – unë kam kërkesë që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e radhës, sepse edhe ai që e ka hartuar këtë strategji nuk është prezent për ta elaboruar pak më gjerë.

Dhe e dyta kjo nuk është strategji si po e shoh unë, por më tepër është një histori e pas luftës dhe e shoh një investim në vlerë prej 13 milion euro. Këtu po e shoh se KK i Gjilanit duhet të jetë pjesë e

investimeve, prandaj mendoj që është një shumë tejet e madhe, kurse komunat tjera nuk marrin pjesë në këtë strategji, nuk është as Parteshi, as Kllokoti dhe Novo Bërda etj.

Izmi Zeka- kanë të drejtë edhe Sokoli dhe Riadi, por kjo është kërkuar nga MPL, do të thotë nga Qeveria e Kosovës e cila ka kërkuar që të bëhet një strategji 2011-2014 për kthim të komuniteteve. Për neve është obligative, por si do ta modelojmë është punë tjetër, por këto investime do të jenë të donatorëve të huaj ose të Qeverisë. Gjilanit nuk do ta ketë si barrë çështjen e mjeteve, por kjo kërkohet urgjentisht të aprovohet një strategji qoftë edhe me shumë defekte. Ato që u thanë për fjalën konflikt dhe të tjera ajo do të ndryshojë, por për çështje të tjera është më tepër aspekt teknik dhe duhet ta aprovojmë.

Arben Malqi- kjo është një pjesë e decentralizmit dhe nuk e di pse është sjell këtu? Ne nuk kemi çka të bëjmë dhe nuk e kam të qartë pse na e kanë sjell neve.

Tahir Arifi- unë fare nuk jam i bindur për të votuar, sepse së pari kjo punë po më duket joserioze, sepse mungojnë njerëzit të cilët duhet ta arsyetojnë para neve. Të vonohet sa të duan kjo strategji dhe le ta marrin përgjegjësinë ata që e kanë marrë për ta bërë këtë punë dhe për ta sqaruar!

Ejup Haziri- të gjitha vërejtjet të cilat u dhanë janë të arsyeshme, prandaj është mirë në seancën e ardhme është më mirë të debatohet derisa t' i shqyrtojmë disa gjëra pak më mirë. Është mirë që edhe atyre që i sponsorizojnë këto gjëra t' i epen vërejtje dhe çdo herë që nuk është prezent sponsorzuesi të mos shqyrtohen fare.

Izmi Zeka- duhet ta thoni pse nuk duhet kalojë kjo pikë, kur në KPF ka kaluar. Në komitetin përkatës ka kaluar, kurse tash është aspekt teknik i KK-së a kalon apo jo? Është procedurë e cila duhet të kalojë.

Riad Rashiti- së pari nuk është paraparë planifikimi i buxhetit për këto 4 vite? për sa familje parashihen të kthehen? Sa është numri i banorëve? Ku do të vendosen? Të jenë gjërat pak më gjerësisht, sepse nuk kemi kurrfarë informate, përveç asaj se janë paraparë 13 milion euro. Dëshiroj që këtë informacione shtesë.

Elisah Ymeri- ne me gjithë vërejtjet që i kemi dhe injorimi që na është bërë nga hartuesi i këtij plani, unë mendoj se ky është interes i shtetit tonë për të kaluar ky projekt, pastaj do të shohim.

Nuk pati debatues të tjerë dhe kryesuesi kërkon që të aprovohet kjo pikë e rendit të punës

Aprovohet pika 12 e rendit të punës me 18 për, kurse 8 ishin kundër

13. Kriteret për ndarjen e bursave dhe shpërblimeve për studentë të dalluar të Gjilanit për vitin akademik 2010/2011,

Shkëlqim Latifi- lidhur me këtë pikë materialin e keni marrë, kriteret janë të paraqitura ashtu siç ka kërkuar Komiteti për Politikë dhe Financa, sepse njëherë na është kthyer rekomandimi dhe është kërkuar që të plotësohet me kritere më në detaje. Ne në mbledhjen e jashtëzakonshme me 25.3.2011 i kemi shqyrtuar kriteret një nga një dhe me një koncenzues të plotë jemi pajtuar, të cilat sot i kemi sjell në Kuvend, të cilat duhet të votohen.

Unë e falënderoj drejtorinë, sepse i ka mjetet e siguruara dhe kërkoj që pasi të merret vendimi kërkoj që të shpallet konkursi. Nga kryesuesi kërkoj që në seancën e ardhshme ta formalizojmë komisionin ose ta plotësojmë.

Elisah Ymeri- unë e përshëndes këtë nismë, sepse është kënaqësi që t'iu ndihmohet studentëve të dalluar. Mirëpo unë i kam disa vërejtje siç ajo për studentët që studiojnë në fakultetin publik dhe atë privat të dallohen me më shumë pikë. Këtë po e them se niveli i cilësisë në mes Universiteti Publik me atë privat jo që dallon, por as që mund të bëhet krahasimi. Nuk është sikur një student ta përfundojë fakultetin në Kembrixh, sikur ai në Prishtinë, nuk mund të poentohen njëjtë.

Nuk është dallimi vetëm 2 me një 1, por është shumë. Ta dimë se në universitetet private, studiojnë disa të cilët kurrë nuk do t'i përfundonin studimet në Universitetin Publik. Mos të harrojmë se në Universitete private nota mesatare sillet diku afër 9.

Tjetër është se propozoj që edhe fakultetet të poentohen me pikë. Nuk është njëjtë sikur fakulteti i edukatës fizike ta përfundosh me atë të mjekësisë ose inxhinierisë.

Duhet të ketë bursa edhe më tepër se një në profile të njëjta, kjo nuk do të duhej të ishte pengesë.

Në pikën 5, kërkoj që familjet e Dëshmorëve të poentohen me një pikë, por jo motër edhe vëlla!

Familja e Dëshmorit është babai, nëna, bashkëshortja, (bashkëshorti) dhe fëmija dhe këto raste të poentohen me një pikë.

Sokol Haziri- në këtë komision ne nuk e kemi të plotësuar vendin, sepse ka qenë dikush i cili nuk na përket neve, prandaj ne do ta dërgojmë emrin e ri për këtë komision.

Sarandë Bllaca- unë sa i përket kësaj pike të gjitha vërejtjet i kam dhënë në komitet dhe këto kritere që i kemi vendos i kemi vendos me të gjithë anëtarët e komitetit dhe përfaqësuesit e partive politike dhe mendoj se ka qenë desh anëtarët e parive politike të jenë në pajtim me anëtarët e komitetit dhe ta debatojnë këtë më gjerësisht. Atë që e tha z. Elisau, në mes fakultetit privat dhe atë publik, ne pas shumë debateve që kemi pasur kemi ardhur në përfundim që ta poentojmë me dy pikë fakultetin publik dhe një atë privat, duke marrë parasysh se edhe fakultetet private i ka licencuar Ministria e Arsimit dhe nuk kemi mundur të bëjmë dallime më të mëdha.

Te kriteret në një pikë thuhet se nuk do të ketë më shumë se dy bursa të profilit të njëjtë. Mirëpo dallimi bëhet në mes të studentëve të profilit të njëjtë. Studenti i mjekësisë krahasohet me atë mjekësisë e jo me ndonjë profili tjetër si matematikë ose kompjuterizëm etj.

Çdo profil do të ketë nga dy bursa.

Grupi i LDD-së i përkrah këto kritere.

Elisah Ymeri- unë po theksoj se për nga niveli profesional do të duhet të dallohet fakulteti prej fakultetit. Edhe fakultet private do të duhet dalluar sipas profesionit dhe profilit.

Do të duhej të jetë studentë të dalluar pa marrë parasysh se çfarë profili janë e jo të thuhet studenti i mjekësisë me atë të mjekësisë.

Sarandë Bllaca-edhe tek familjet e Dëshmorëve ne i kemi bërë me nga një plus, nëse janë dy kandidatë janë të barabartë, por njëri është i familjes së Dëshmorit, pastaj ai që e ka plusin t'iu ndahet bursa. Nuk kemi desh ta poentojmë me pikës, sepse këto janë bursa për suksesin e studentëve dhe ndryshe janë ndihmat sociale, ndryshe janë bursat.

Elisah Ymeri- unë dhashë vërejtje që familje e Dëshmorëve nuk mund të jenë vëllai dhe motra dhe nën dy duhet pasur parasysh se fëmijës që i mungon njërin prind do ta ketë më vështirë për të studiuar. Ai që i ka të gjitha kushtet edhe prindërit do ta kenë më lehtë, për atë unë e kam thënë që të paktën t'iu jepet një pikë jo më shumë.

Arben Maliqi- unë fillimisht e përshëndes Komitetin e Arsimit i cili e ka bërë një punë të mirë dhe kryesisht kriteret të cila ti ka bërë janë kritere shumë të mira. Mirëpo unë këtu i pash dy diskriminime. Nuk ka dallim në mes të studentëve të cilët studiojnë në universitete publike dhe private, për mendimin tim janë të barabartë, sepse edhe universitet private janë të licencuara dhe kjo për mua bie menjëherë. Tjetra , unë jam për ta hequr plusin, por më pëlqeu ajo që e tha Elisau, familja e Dëshmorëve dihet se cila është, janë bashkëshorti-ja dhe fëmija.

Riad Rashiti-po ndodh shpesh që në KPF po epen propozime po kalojnë, kurse kur po vijnë këtu nuk po vlerësohen. Është drejtori i Arsimit këtu dhe është thënë në komitet që këtu janë propozuar 30 bursa, por propozoj të ndahen 40 bursa dhe mendoj se ka kaluar për 40 bursa. Kjo është nëse nuk gaboj.

Bahrie Veseli- kërkoj nga drejtori i Arsimit që nëse ka mundësi të bëhet një shtesë, për një numër të konsiderueshëm të vajzave që udhëtojnë nga fshatrat në shkolla të mesme. Këtyre vajzave së paku t' i sigurohet bileta mujore dhe të përfshihen në këtë buxhet. Është mirë të plotësohet kjo kërkesë, sepse një biletë mujore nuk kushton më tepër se njëzet euro dhe këtu është fjala për disa vajza të cilat kanë vetëm njërin prind.

Ndërsa sa i përket studentëve që studiojnë në universitete private, ata kanë buxhet dhe mundësi më të mira, kurse ne nuk jemi të obliguar të bëjmë krahasime për mënyrën e kualitetit të studimeve në mes këtyre dy universiteteve.

Gjithashtu duhet të favorizohen drejtimet të cilat janë deficitare për Komunën tonë, si janë shkencat matematikore-natyrore dhe ato kompjuteristike.

Xhyzide Ismaili- së pari përshëndes Drejtorinë e Arsimit për ndarjen e këtyre bursave edhe pse është një numër mjaft i vogël i bursave, mirëpo Gjilani për herë të parë po ndan edhe shpërblime për studentë të dalluar të cilët deri më tani nuk janë shpërblyer asnjëherë nga Komuna.

Komiteti ka marrë si kriter që të shpërblehen ata studentë me nga 200 euro, por unë mendoj që është më mirë që kjo shumë të zvogëlohet, por numri i studentëve të rritet.

Jakup Bajrami- unë kam një sugjerim tek kriteret aty ku parashihet dallimi në me universitetit publik dhe atij privat, sipas meje çdo universitet i cili është i licencuar do të duhej të jetë i barabartë. Këtë e them, sepse ata profesorë të cilët mbajnë mësim në universitet publik, japin mësim edhe në universitete private. Për logjikën time këto universitete do të duhej të jenë të barabarta dhe nuk është mirë të bëhen këso dallime.

Tahir Arifi- unë pajtohem me atë që e tha zotëri Bajrami dhe ne nuk kemi të drejtë për ta bërë këtë ndarje, sepse kjo do të jetë edhe shkelje e të drejtave të njeriut dhe shkelje e ndonjë ligji në Kosovë. Unë do ta votoj këtë si e ka propozuar komiteti, por me droje se jemi duke gabuar. Studentët e mirë janë të mirë ku do që të jenë ata. E dyta do të dua për ta ditur cilat janë universitetet publike?

Ejup Haziri- unë po nisem nga ajo që e thamë pak më herët se në vitet e kaluar patëm vërejtje ndaj komiteteve të cilat nuk po punojnë. Komiteti ka vendos, këta janë profesionistë dhe janë të lidhur me arsimin, sepse janë në proces arsimor. Secili prej neve do t' i ketë variantet veta, propozimet nuk mund të ndalen kurrë. Unë po kthehem në atë pikë fillestare dhe pasi komiteti i ka bërë këto kritere dy herë, i ka bërë njëherë ia kemi kthyer prapa i ka bërë për të dytën herë, prandaj unë propozoj t' i miratojmë ashtu siç i ka bërë komiteti.

Elisah Ymeri- pse te ne nuk i ka poentuar Ministria e Arsimit me 1,2 dhe 3 nivelet profesionale është tjetër çështje, por niveli Komunal po i ndan këto ndihma dhe ne kemi të drejtë të vendosim

Florinë Zymberi- unë e përkrahu Elisaun, kjo është shumë e vërtetë, sepse unë kur kam qenë studente 4 muaj e kam përgatit një provim, kurse tash duke u shëtitur merret nota 10.

Leonorë Bunjaku-është në pyetje ndarja e bursave dhe këtu po bëhen diskriminime në mes universiteti publik dhe atij privat. Çka do të ndodh me ata studentë të cilët i përfundojnë studimet në universitete private, a thua edhe në punësime do të bëhen këso lloj debatesh? Kjo është ashtu si e tha z. Jakup Bajrami, sepse të njëjtit profesorë punojnë në dy universitetet. Me një fjalë tash studentët po viktimizohen!

Izmi Zeka- KK i Gjilanit nuk e ka atë obligim për t' i vlerësuar universitetet, janë kriteret në komitet, dy pikë i ka Universiteti Publik i Prishtinës, një është për fakultetet private. Kërkoj që familjet e ngushta të Dëshmorëve të kenë një pikë dhe jo plus. Familja e ngushtë është babai, nëna, bashkëshorti-ja dhe fëmija.

Arben Malqi- mua po më habit një fakt, pse ne e votuam më parë partneritetin privato - publikë – PPP-në? Dhe mos të harrojmë se ata të cilët kanë pasur të holla janë regjistruar pa problem në Universitetin Publik. Mua po më habit fakti se si guxojmë ne si KK- ta përdorim fjalën diskriminim? Kjo është diskriminim dhe nuk pajtohem me këtë! Këtë nuk guxojmë të bëjmë!

Sarandë Bllaca- nuk është e vërtetë që nuk punohet në fakultete private, sepse edhe vetë punoj në fakultet private dhe ajo bie poshtë menjëherë. E dyta edhe ministri Blerandë Stavileci i ka përfunduar studimet në fakultet privat. Shpërblimet nuk janë mujore, ajo merret njëherë dhe përfundon puna ma atë rast. Unë kërkoj që të bëhet barazimi në mes fakulteti privat dhe atij publik.

Mimozë Kadriu- komiteti në kriteret i ka paraparë edhe studentët të cilët studiojnë jashtë Kosovës në Maqedoni dhe Shqipëri. Në këto kriteret nuk është paraparë ndonjë pikë për këto dy vende, prandaj duhet paraparë këtë.

Shukrie Rapuca- ne në komitet kemi ardhur në përfundim që këto kriteret të cilat sot po i paraqesim, të merren parasysh edhe këto vërejtje që u dhanë. Edhe unë pajtohem me atë kriterin për familjet e dëshmorëve të kenë një pikë e jo plus siç u tha nga disa.

Mirëpo për çështjen e fakultetit privat dhe publik, për të cilin rast u debatuar mjaft, unë po theksoj se në punësim nuk vlen ky kriter dhe nuk pyet askush se çfarë fakulteti ka përfunduar kandidati privat apo publik, por në institucione këta të fakultetit privat janë më të avancuar.?

Shkëlqim Latifi- unë edhe njëherë iu bëj ftesë që t' i përkrahini këto kriteret në këtë formë si i kemi sjell në Kuvend. Ne për këtë kemi debatuar gjatë dhe e kemi marrë si kriter që Universiteti Publikë t' i ketë dy pikë. Ne i kemi pasur në dorë të tërë dokumentacionin dhe kemi konstatuar se në Universitet Publik mesatarja notës mezi që arrin në 7.5, kurse në atë privat 9.5, mirëpo shumica prej tyre dhe janë në marrëdhënie pune. Këtë e ka bërë komiteti më arsyetim dhe duke besuar se Universiteti Publik është më kualitativ. Ne nuk jemi të kënaqur me 50 bursa ata janë pak, por ne do të angazhohemi për të biseduar edhe me komunitetin e biznesit dhe mundësisht do ta rrisim numrin. Ndërsa vitin e kaluar për fëmijët e dëshmorëve kanë qenë 5 pikë. Edhe njëherë iu ftoj që t' i përkrahini këto kriteret.

Selim Selimi- unë desha të pyes se në këto kritere a është paraparë ndarja e ndonjë burse për komunitetet pakicë të cilat janë në Komunë të Gjilanit, në këtë rast konkret e kam fjalën për komunitetin turk.

Bujar Nevzadi- mua së pari më duket se më parë komitetet kanë punuar më mirë dhe grupet janë harmonizuar më mirë. Të gjitha grupet politike i kanë dërguar përfaqësuesit e vet dhe këtë çështje e kemi debatuar mjaft gjatë në komitet. Mirëpo edhe këto vërejtje që i dhatë sot, unë do t' i kem parasysh, por edhe iu ftoj që ta formalizoni komisionin ose t' i vazhdoni mandatin atij të mëparshmit, sepse ka punuar mjaft mirë, me një përjashtim që AAK, duhet ta plotësojë me një anëtar. Ne do të jemi shumë transparent dhe atë punë të komisionit do ta sjellim në Kuvend dhe nuk do të gabojmë, punën do ta kryejmë mirë, prandaj iu ftoj që ta mbështetini këtë propozim.

Zonja Bahrie i pat disa kërkesa, por ajo këto le t' i drejton në DA dhe ne e bëjmë transportin nxënësve, prandaj nuk do t' lëmë asnjë nxënës për shkaqe materiale të mos vijojë shkollën.

Izmi Zeka- në fund të debatit kryesuesi kërkoi që të miratohet propozimi për ndarjen e 50 bursave dhe 20 shpërblimeve për studentë të dalluar?

Aprovohet pika 13 e rendit të ditës me shumicë të votave të anëtarëve të Kuvendit, kurse 1 ishte kundër

Izmi Zeka- në kritere, kush është që për Familje të Dëshmorëve të jetë një pikë

Aprovohet me vota unanime, ky kriter

Izmi Zeka – kush është për atë që komisioni të jetë prej 5 anëtarëve dhe ata njerëz të jenë në komision, por nëse eventualisht grupet politike, dëshirojnë për ta tërheq ndonjë anëtarë mund ta bëjnë këtë? Në këtë komision PDK do të ketë një anëtar, LDK, 1, LDD 1, AAK 1, komuniteti 1.

Aprovohet ky kriter, me shumicë të anëtarëve të Kuvendit, kurse përfaqësuesit e AKR-së abstenojnë.

14. Informatë 3 mujore e punës së Komiteteve të KK-s,

Izmi Zeka- kjo është një informatë sa për ta pasur ju, sepse kemi një mos pajtim me drejtoritë dhe me komitete, kurse e dyta disa komitete nuk janë duke funksionuar fare?

Kjo është arsyeje pse e kemi bërë një pasqyrë të tillë për t' u bindur kryesuesit e komiteteve sa kanë punuar? Ne në një të ardhme do të bëjmë edhe disa ndryshime në komitete, sepse disa prej tyre nuk po e harmonizojnë punën mirë me drejtoritë dhe nuk po kryhet puna ashtu si duhet. Me shefat e grupeve do të bisedojmë lidhur me përbërjen e komiteteve dhe do ta shikojmë edhe barazinë gjinore dhe kështu nuk do të kemi problem.

Florinë Zymberi- i dëshiroj punë të mbarë drejtoreshës së DUMM, por besoj se tash e tutje do të kemi bashkëpunim më të mirë, sepse gjatë tërë kohës kam bërë përpjekje, por në disa raste kemi mbetur prapa. Tash e tutje do të kemi bashkëpunim më të mirë.

Ibrahim Neziri- është në rregull që të bëhen disa ndryshime në komitete, por në këtë kërkesë të jetë edhe Këshilli i ekspertëve, sepse ky këshill që nga fillimi i ka mbajtur një apo dy mbledhje.

Nevzad Rushiti- unë nuk jam kryetar i Komitetit të pronës, por është z. Ali Arfifi, por kam bindjen se i kemi mbajtur mbledhjet rregullisht dhe jemi ndër komitetet më të mira.

Florinë Zymberi- nuk është e nevojshme edhe për një pikë të ditës të mbahet mbledhje e komitetit, sepse aty ka edhe shpenzime, prandaj duhet pasur kujdes për ta ruajtur buxhetin.

Shpresë Hajdari- ne po i mbajmë nga dy mbledhje në muaj, por së paku duhet që komitetet ta mbajnë nga një mbledhje dhe t' i përmbahemi agjendës vjetore që në çdo muaj ta mbajmë nga një mbledhje. Komiteti për Kulturë është si shembull i keq dhe për 3 muaj ka mbajtur vetëm një mbledhje.

4. Të ndryshme,

Sokol Haziri- së pari desha që kryetari të jetë këtu, por ai në këtë çast nuk është këtu dhe kisha desh që të na njoftoj për ndryshimet të cilat kanë ndodhur në Qeverinë Komunale.

U përmend këtu drejtoresha e DUMM, prandaj unë e di që është përgjegjësi e kryetarit të Komunës për t' i informuar këshilltarët për ndryshimet të cilat ndodhin në qeveri.

Deri në seancën e ardhme do të kisha pas dëshirë që t' i kemi këto informata.

Abdyl Aliu- më vjen shumë keq që në këtë Kuvend, nuk ka shumë futboll dashes, sepse pak prej neve i takoj në Stadiumin e qyteti duke përcjell ndonjë ndeshje të futbollit. Mua më vjen keq për këtë gjendje në të cilën gjendet Stadiumi. I kemi dy ekiye të cilat do të hyjnë në super lig e të cilat janë ekiye për të cilat na kanë lakmi e tërë Kosova, kemi shumë futbollistë të mirë që premtojnë shumë, e kemi një derbi të cilin nuk e ka askush në Kosovë dhe më gjerë, por edhe niveli i shikueshmërisë është më i miri në Kosovë. Mirëpo kemi edhe diçka për të cilën nuk mund të krenohemi, kemi fushën më të dobët në Kosovë.

Për këtë kërkoj ndonjë informatë nga drejtori se a ka në plan për të ndërmarrë diçka?

E dyta më interesojnë projektet ndërtimore dhe të tjera nga ministria ose komuna, më intereson se a posedojnë leje ndërtimi komuna apo ministria për këto projekte?

Këtë po e them se ka raste kur një qytetarë nuk mund të marrë leje ndërtimi, sepse i thuhet se nuk ka plan urbanistik, kurse në të njëjtin vend, Komuna apo ministria ngrisin objekte ndërtimore?

Pyetje e ime është për DUMM se a janë duke i pajisur me leje ndërtimore rastet të cilat i përmenda?

Izmi zeka – z. Abdyli përgjigjen me shkrim do ta ketë në seancën e ardhshme, nga drejtori i Kulturë dhe nga ai i Urbanizmit.

Selever Xhelili- ne kemi filluar që të marrin masa për Stadiumin, sepse e dimë që dy klubet sportive janë shumë afër super ligës, prandaj Federata mund të mos i pranojë në atë Stadium aktual. Kjo është shqetësim i madh për DKRS-në, po ne kemi biseduar edhe me kryetarin dhe me përfundimin e këtij sezoni me 30 maj, do të fillojmë me renovimin e Stadiumit. Mirëpo duhet parë edhe gjendjen financiare, sepse sipas parashikimeve aty duhet të ketë investime mbi 100 mijë euro.

Nuk pati debatues të tjerë dhe në ora 17 seanca përfundoi punimet.

Procesmbajtësi

S. HASANI

Kryesuesi i Kuvendit

I. ZEKA